

# TAKIMET E GJEÇOVIT 2007

(Përgatitën: Frrok KRISTAJ  
e Nikollë KËRHANAJ)

*Redaktor:*

Atë Ndue KAJTAZI

*Këshilli për botim:*

Nikollë KËRHANAJ

Frrok KRISTAJ

Mihill PREKLUSHAJ

Atë Ndue KAJTAZI

Lajde KOLËGJERAJ

Bibë BERISHA

Hilë GJEVELEKAJ

Nokë P. LEKAJ

Kolë N. PREKPALAJ

Gjokë KOLËNDREKAJ

# **TAKIMET E GJEÇOVIT 2007**

*(Përgatitën: Frrok KRISTAJ e Nikollë KËRHANAJ)*

Klubi letrar “SHTJEFËN GJEÇOVI”  
Zym – Has  
2008



## Parathënia

Manifestimi tashmë tradicional letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Gjeçovit”

që tash e 36 vjet mbahet pa asnjë ndërprerje në Zym të Hasit të Thatë, komuna e Prizrenit, tubon krijuesitë letrarë, publicistikë e të tjerët, që krijojnë në Zym, por edhe në mbarë viset e Hasit. Ky manifestim mbahet në kuadër të Klubit letrar “Shtjefën Gjeçovi”, që vepron në Zym, por që ndihmohet nga mbarë banorët e Zymit, Bregdinit e të Shëngjergjit, pastaj të Famullisë së Zojës së Hasit, Bashkësisë së lokalitetit në Zym e të asociacioneve të tjera në vend, si dhe nga banorët e fshatrave të tjera të Hasit dhe më gjerë. Krah i fortë i këtyre aktiviteteve padyshim se janë zymjanët dhe hasjanët që jetojnë e punojnë në Prishtinë e qendrat tjera të Republikës së Kosovës.

Anëtarë të rregulltë të Klubit letrar “Shtjefën Gjeçovi” konsiderohen të gjithë krijuesit letrar e të fushave të tjera të fshatrave të Hasit, si dhe të hasjanëve që jetojnë e veprojnë edhe jashtë Hasit.

Zhvillimit të aktiviteteve të Klubit letrar, pastaj mbajtjes së manifestimit “Takimet e Gjeçovi”, aktiviteteve të SHKA “Katarina Josipi” të Zymit e të tjera, mbështetje materiale në vazhdimësi i kanë dhënë mërgimtarët tanë të organizuar në Shoqatën “Hasi”, përkatësisht “Zymi”, që veprojnë në Kroaci (me seli në Zagreb), por edhe në shtetet tjera nëpër Evropë e në SHBA.

Këshilli organizativ i manifestimit letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Gjeçovit”, që mbahet në Zym, pasi në 35-vjetorin e manifestimit botoi monografinë “Takimet e Gjeçovit 1971-2006”, vendosi që tash e tutje të botojë për çdo vjet almanakun e manifestimit, ku do të përfshihen të gjitha aktivitetet

kulturore që zhvillohen në Bashkësinë e lokalitetit të Zymit brenda dy manifestimeve.

Dhe, tash kur po e botojmë almanakun e manifestimit të 36 me radhë, po theksojmë se për veteranët e këtij manifestimi, por edhe për të tjerët, ishte ëndërr që ta mbajmë manifestimin në Republikën e Kosovës shtet dhe të pavarur. Kjo aspiratë u realizua me angazhimin e mbarë popullit shqiptarë (nga të gjitha viset etnike) në luftën çlirimtare për liri e pavarësi të Kosovës, por edhe të miqëve tanë, sidomos të SHBA-ve dhe të shteteve të BE-së.

Almanaku i sivjetmë përfshinë aktivitetet kulturore të zhvilluara në Zym brenda dy manifestimeve të “Takimeve të Gjeçovit”.

**Frrok KRISTAJ**

## **Manifestim i denjë me traditë kombëtare e shpirtërore**

*Zym, 13 tetor 2007* - Në Zym të Hasit të Thatë, komuna e Prizrenit, u mbajt manifestimi letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Gjeçovit”, përkatësisht edicioni i 36 me radhë i këtij manifestimi. Në këtë manifestim kësaj radhe përveç pjesëmarrësve të shumtë, mori pjesë edhe Arben Çejku, i ngarkuar i Zyrës Ndërlidhëse të Shqipërisë në Prishtinë, Akademik Mark Krasniqi, kryetar i PSHDK-së, Veton Surroi, kryetar i PR “Ora”, Sylë Hoxhaj e Kadri Kryeziu, zëvendësministra, Prenkë Gjeta e Skënder Zogaj, kryetar i komunës së Klinës, përkatësisht i Fushë Kosovës, Hasan Luma, drejtor i Drejtoratit të Kulturës të komunës së Lipjanit, Hasan Hoti, drejtor i Drejtoratit të Arsimit të Prizrenit, përfaqësuesit e fshatit Karvansari të komunës së Malishevës e shumë të tjerë. Organizatorët me këtë rast shqiptarëve të besimit islam i uruan Festën e Bajramit.

Do përmendur se manifestimin “Takimet e Gjeçovit” e shpalli të hapur Nikollë Kërhanaj, kurse e përshëndeti Akademik Mark Krasniqi, Veton Surroi, Asqeri Llanaj (nga Vlora) dhe Dr. Don Shan Zefi, famullitar i Zymit.

Në vazhdim Nikollë Kërhanaj foli për “Abetarja e Zymit 1900”, kurse lapidarin “Abetarja e Zymit 1900” e zbuluan

Arben Çejku, përfaqësues diplomatik në Zyrën Ndërlidhëse të Shqipërisë në Prishtinë, e Nikollë Kërhanaj.

Në pjesën e dytë të manifestimit “Ora e Anton Pashkut” së pari Eleonora Luz Prekpalaj deklamoi vargje të Agim Devës e më pastaj u shënuar 70-vjetori i lindjes së Anton Pashkut.

Po ashtu, në “Orën e Anton Pashkut” poezit e veta i lexuan Mark Krasniqi, Shaqir Përvizaj, Nehat S. Hoxha, Hatixhe Çollaku - Ademaj, Demush Berisha, Haxhi Vokshi, Arben Rashkaj, Fatime Ahmeti, Fatos Rushiti, Arben Ibrahim, Skënder Zogaj, Vilson Culaj, Rexhep Smajlaj, Miradije Ramiqi, Shqipe Hasanaj dhe Prend Buzhala.

Organizatorët si gjithmonë edhe kësaj radhe dhanë çmimin tradicional për të arritura në kulturë “Atë Shtjefën Gjeçovi”. Në fakt, juria e përbërë nga Frrok Kristaj, kryetar, Petrit Palushi (nga Kukësi) dhe Isak Ahmeti, anëtarë, kësaj radhe çmimin e përmendur ia ndanë Arbnesheve të Zarës së Dalmacisë në Kroaci. Po ashtu organizatorët për të dytën herë me radhë dhanë edhe çmimin “Unaza e Katit” (Katarina Josipi). Kësaj radhe ndanë dy unaza, përkatësisht ky çmim iu dha Hermine Lekajt dhe Lajde Kolëgjerajt. “Unaza e Katit” që iu dha Hermine Lekajt ishte punim i Rafael Kocit, argjentar nga Zagrebi, përkatësisht donacion i Akil Kocit, që e dorëzoi Sylë Hoxhaj, kurse “Unaza...” që iu dha Lajde Kolëgjerajt ishte donacion i Gjokë Kolëndrekajt, që e dorëzoi vet donatori.

Po ashtu, djali i shkrimtarit tashmë të ndjerë Rifat Kukaj organizatorëve u dhuroi një sasi të ekzemplarëve të romanit më të ri të Rifat Kukajt, që doli nga shtypi ditë më parë, si dhe Greta Kaçinari fali disa ekzemplarë të veprës së Gjergj Kaçinarit.

Do përmendur se në vigjilie të manifestimit, zymjanët promovuan monografinë e Atë Ndue Kajtazit, Nikollë Kërhanajt, Hilë Gjevelekajt e Frrok Kristajt “Takimet e Gjeçovit 1971-2006”, si dhe shënuan 50-vjetorin e sportit në Zym të Hasit, ku ndër të tjera u tha se “Krahas aktivitetëve

kulturale e arsimore që janë zhvilluar në mesin tonë, në vitin 1957, pra pikërisht para 50 vjetëve, në Zym filloi edhe zhvillimi i sportit. Nga shumë gjini sportive, që ekzitojnë, në Zym sporti zë fill me futboll. Në vitin 1957, me nisjativën e Gjini Lazër Kërhanajt, Nokë Noz Kolëgjerajt, Dedë Gjekë Pecollaj e shumë të tjerë, kishin organizua një ndeshje miqësore me Krushën e Madhe. Megjithatë, futbollit në Zym daton edhe më herët. Bie fjala, në fillimin e viteve të pesëdhjeta në Zym ishte në detyrën e mësuesit ishin edhe Iljaz Llausha, Bedridin Celina, Zenun Kadri Çollaku e të tjerë. Bile topin e parë të futbollit në mesin tonë e ka sjell Iljaz Llausha, që atëbotë luante futboll për skuadrën e “Metohisë” (më vonë e tash “Liria”) të Prizrenit.

Kësaj radhe nuk do të zgjerohemi shumë, por pa dashtë që të jemi rob të ndonjë rënditje sipas kohës, do t’i përmendim disa njerëz tanë që i kanë kontribuar zhvillimit të futbollit në Zym. S’do mend se futbollit në Zym nuk mund të merret me mend nëse nuk përmendet Gjini Lazër Kërhanaj, por janë edhe një mori të tjerë që i kanë kontribuar kësaj disipline sportive, si Nokë Kolëgjerajt, Dedë Pecollaj, Lazër Dedë Kajtazi, Zef Ton Kolëgjerajt, Mark Bibë Berisha, Gjokë Mark Dulaj, Dedë Hilë Prekpalaj, Luz Noc Kolëgjerajt, Gjon Lazër Kërhanaj e shumë të tjerë. Duhet përmendur se në vitin 1964, në Trebinje të Hercegovinës ka luajtur Dedë Pecollaj për ekipin “Hercegovac”.

Në vitin 1960 ekipi i futbollit të Zymit u bashkua me atë të Rogovës dhe kështu themeluan skuadrën e futbollit me emrin “Pashtriku”, skuadër kjo që bëri gara në nënlidhjen futbollistike të Prizrenit. Në ekipin e “Pashtriku” përveç disa lojtarëve nga Rogova, si Beqë Morina e Islam Gashi, nga Zymi ishin të angazhuar Gjini Kërhanaj, Prekë Engjëll Kolëgjerajt, Shtjefën Lazër Kërhanaj, Nikollë Dulaj, Zef Kryeziu, por edhe trajneri i të cilëve ishte Rifat Malazogu, nga Gjakova.

Po ashtu, nga Zymi kanë qenë të angazhuar edhe Pren Prenkaj, Ndrecë Preklushaj, Noz Ukë Prekpalaj, Tadej Prekpalaj, Musë Çollaku, Dodë Gjon Prekpalaj, Nikollë Kërhanaj e shumë e shumë të tjerë. Ndërkaq, më 19 maj 1974, në Zym u themelua klubi futbollistik “Përpjekja”, kryetar i të cilit ekip u zgjodh Gjini Kërhanaj, kurse në ekip herë pas here ishin angazhuar Hilë Gjevelekaj, Shyqëri Totaj, Ndue Kolëgjeraj, Lazër Shtjefën Prekpalaj, Luz Mikel Prekpalaj, Mihill Luz Preklushaj, Bedri Çollaku, Isa Çollaku, Zenun Çoçaj, Elez Çoçaj, Sadri Brahaj, Zef Xhekë Prekpalaj, Zef Berisha, Hilë Lazër Prekpalaj, Engjëll Dulaj, Engjëll Kolëndrekaj, Velimir Grubački, Frrok Kristaj, Nokë Pjetër Dulaj, Zef Lazër Pecollaj, Prekë Kolë Kristaj, Jetish Kristaj, Lazër Bibë Prekpalaj, Ndrekë Pal Prekpalaj, Nokë Noz Muçaj e të tjerë.

Do përmendur se disa të rinj nga anët tona, kanë luajtur edhe për reprezentacionin e ish-Jugosllavisë, përkatësisht të Serbisë, si Joakim e Igor Dulaj, Ndue Pjetër Berisha, Marin Nokë Muçaj e të tjere, sikurse edhe për reprezentacionin e të rinjve të Kroacisë Gjon Pal Lekaj.

Në anën tjetër, hendboll për Prizrenin ka luajtur Martin Tush Lekaj, Shtjefën Kolëndrekaj (që më vonë kanë luajtur edhe për reprezentacionin e Jugosllavisë) e Frrok Kristaj.

Për kuriozitet do ta sjellim edhe një fakt shumë interesant. Bie fjala, Tereze Pashë Kajtazi, derisa jetonte në Vojvodinë, kishte luajtur hendboll, e me kalimin e saj në Kroaci, luajti futboll për reprezentacionin e Kroacisë.

Të theksojmë se futbollistët e Zymit përveç që nuk kanë pasur kushte elementare, ata janë ballafaquar sidomos me mungesën e fushës. Bile, në vitin 1975 me nisjativën e Frrok Kristajt, Mark Berishës e të Gjini Kërhanajt, në Ledinën e Shën Kollit filloi ndërtimi i fushës sportive. Më vonë me nisjativën e Hilë Lazër Prekpalajt u ndërtua fusha e sporteve të vogla në qendër të Zymit, sikurse edhe me nisjativën e Lazër Bibë Prekpalajt e

të Prekë Kolë Kristajt u ndërtua fusha e futbollit në Shëngjergj”.

Ndërkaq, në ditën e manifestimit “Takimet e Gjeçovit 2007”, në lagjen Berishë ku gjendet shtatorja e Nënës Tereze, pjesëmarrësit shënuan 10-vjetorin e kalimit në amshim të kësaj figureje të madhe, për të cilën foli Atë Ndue Kajtazi.

Po ashtu, ditën e manifestimit pjesëmarrësit vunë lule të freskëta mbi varrin e Atë Shtjefën Gjeçovit, Atë Luigj Palajt, Katarina Josipit, Anton Pashkut, që gjenden në fshatin Shëngjergj, si dhe te shtatorja e Nënë Terezës në lagjen Berishë të Zymit.

Në fund të manifestimit programin e vazhdoi SHKA “Katarina Josipi” e Zymit, ku së pari u paraqit me një këngë Greta Dulaj, që edhe e moderoi këtë manifestim, e pastaj anëtarët e kësaj shoqërie interpretuan rite të Festës së Bajramit dhe hodhën valle tradicionale e artistike, që u pëlqyen shumë nga të pranishmit.

Legjenda: 1. Lapidari i “Abetarja e Zymit 1900”

2. “Takimet e Gjeçovit 2007”

## **Albert MARJAKAJ**

### **U zbulua shtatorja e Atë Shtjefën Gjeçovit**

*Zym, 3 nëntor 2007* - Para plotë 36 vjetësh në Zym të Hasit të Thatë, me iniciativën e Frrok Kristajt u themelua Klubi letrar “Shtjefën Gjeçovi”, përkatësisht filloi manifestimi letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Gjeçovit”. Qysh atëbotë ëndërrohej që Gjeçovit të madh t’i ngrihej një shtatore. Megjithatë, symini i zymjanëve, përkatësisht i hasjanëve, filloi të realizohej me fillimin e ngritjes së Kompleksit Përkujtimor “Atë Shtjefën Gjeçovi”, gurin themeltar të të cilit e pat vënë

ipeshkvi tashmë i ndjerë Imzot Mark Sopi, në “Takimet e Gjeçovit 2003”. Dhe, zymjanët për këtë Kompleks deri më tash kanë dhënë mbi 200 mijë euro. Në Kompleksin Përkujtimor kanë planifikuar të vendosin shtatoret e Atë Shtjefën Gjeçovit, Imzot Pjetër Bogdanit, Katarina Josipit dhe të Anton Pashkut. Ëndërra e zymjanëve tashmë po bëhet realitet. Ditë më parë në atë Kompleks u vendos shtatorja e Atë Shtjefën Gjeçovit.

Në fakt, jehona e kabanave të drekës së ditës së shtunë, më 3 nëntor 2007, e sollti Atë Shtjefën Gjeçovin tashmë në bronz (të punuar nga skulptori shkodran Sadik Spahija) nga Kisha e Zymit, ku ai shërbeu, në Kompleksin Përkujtimor “Atë Shtjefën Gjeçovi”.

Në manifestimin e organizuar me këtë rast, Greta Dulaj, që e udhëhoqi manifestimin, së pari në emër të zymjanëve përshëndeti të pranishmit, e veçmas Agim Veliun, ministër i arsimit të Kosovës, pastaj Sylë Hoxhaj e Mark Komoni, zëvendësministra, Hasan Zekaj, përgaqësues i Ministrisë së Kulturës të Kosovës, Hasan Hoti, drejtor i Drejtoratit të Arsimit të Prizrenit, Hasan Luma, drejtor i Drejtoratit të Kulturës së Lipjanit, Thoma Thomai, skulptor, Moikom Zeqo, shkenctar, Patër Land Jaku, guardian françeskan, Fatmir Miziri, Dylber Neziri e Agim Disha, përfaqësues të Fondacionit Artistik, që të gjithë nga Tirana, Haxhi Galluci, nënkryetar i Bashkisë së Fierit, Skënder Zogaj, kryetar i komunës së Fushë Kosovës, Ton Marku, kryetar i Unionit Shqiptar në Kroaci e shumë të tjerë.

Më pastaj u ftua nismëtari i të gjitha veprimtarive kushtuar Shtjefën Gjeçovit në Zym e Janjevë, Frrok Kristaj. Me atë rast Frrok Kristaj ndër të tjera tha se jemi tubuar në këtë vend të shenjtë të ngjallim në kujtesën tonë të madhin Atë Shtjefën Gjeçovi.

Atë Shtjefën Gjeçovi padyshim se është njëra ndër figurat më të shquara të lëvizjes atdhetare, të kulturës kombëtare, të shkencës dhe të letërsisë shqiptare. Tërë jetën u dallua për

dashuri të pakufishme ndaj Atdheut, popullit, kishës, gjuhës amtare, ndaj shkollës dhe artit shqiptar, ndaj vlerave të kulturës materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve. Atë Shtjefën Konstantin Gjeçovi - Kryeziu është figurë dhe personalitet poliedrike: mësues dhe dijetar, poet, prozator e gjuhëtar, dramaturg, përkthyes, arkeolog, speleolog, etnograf, folklorist dhe publicist. Mbi të gjitha, ai është atdhetar, rilindës dhe kodifikues i parë i “Kanunit të Lekë Dukagjinit”.

Mëhill Gjeçovi, apo siç njihej në rrethin e tij Hili i vogël, që më vonë e mori emrin Shtjefën Gjeçovi, u lind (nga i ati Matë dhe e ëma Ana Gjeçi) në Janjevë, më 12 korrik të vitit 1874. U shkollua në vendlindje, pastaj në Troshan të Shkodrës, në Fojnicë, Dërventë, Banjallukë dhe Kreshevë të Bosnje e Hercegovinës. Më 25 korrik të vitit 1897, shugurohet meshtar në Zllakuqan të Klinës. Stacionet e shërbimit të tij do të jenë Troshani, Peja, Zllakuqani, Gllogjani i Pejës, Laçi, Kurbin, Zara (në Dallmaci të Kroacisë), Livno (në Hercegovinë), Shkodër, Gomsiqe, Sapë, Theth, Prekal, Rubik, Vlorë, Gjakovë dhe Zym, ku më 14 tetor të vitit 1929 u pushkatua nga pushteti okupator serb. U varros me nderime të mëdha në varrezat e Kishës së Shën Prenës, në Shëngjergj të Hasit.

Studiuesit e jetës dhe veprës së Atë Shtjefën Gjeçovit e kanë konsideruar figurën e tij ndër më të ndritshmet e më të shquarat e historisë dhe kulturës sonë kombëtare. Ndaj, ai është konsideruar por edhe vazhdon të konsiderohet edhe sot, njëra ndër shembëlltyrat më të shkëlqyera për t’i ruajtur, ringjallur dhe për t’i bërë të pavdekshme visaret popullore që kanë vlera të jashtëzakonshme.

Duke e shpalosur figurën e Atë Shtjefën Gjeçovit, shpalosim aspekte të identitetit tonë kombëtar dhe rrënjët e thella të kulturës sonë, që përkujton edhe disa nga kapitujt më tragjik e më krenarë të historisë sonë.

Atë Shtjefën Gjeçovi na la trashëgim një fond prej më se 10 mijë faqe materiale të fushave nga më të ndryshmet, që

përbëjnë më se 75 vepra, prej tyre deri më tash të botuara mbi 25 sosh.

Atë Shtjefën Gjeçovi kudo që shërbeu la vulën e shkollës shqipe, la gjurmët në arkeologjinë shqiptare, në sociologjinë e familjes shqiptare, etnografi... Dhe, pikërisht për kontributin që jepte derisa hulumtonte, shkruante e botonte, edhe Universiteti i Lajpcigut të Gjermanisë e laureoi me çmimin Honoris Causa. Dhe, në shkrimin “Çka asht Atdheu”, që e botoi edhe në veprën “Agimi i Gjydetnis”, Gjeçovi ndër të tjera thotë: “Atdhetar i mirë e i ndershem asht në detyrë me dashtë atdheun e vet, e djersët e ballit me i derdhë për dobi të tij; me i qindrue në kambë çdo urdhëni të tij; me ju ngjit dorën të lanunve e nevojtareve; me ju ndejtë të parëve në ndigjesë; me këshillue ate që ka mendjen ndërduzash e me qenë krejt i atdheut e i kombit... Atdhetar i mirë ka me qenë: qeverisës i dëgjueshëm, ushtar trim, prijës zemrak, babë i dashtun, zotni i njerëzishëm, rrogat besnik, dashamir i pabishta e shok i mirë”.

Duke u nisr nga këto këshilla dhe mësimë, por edhe nga fakti se Atë Shtjefën Gjeçovit i pushojnë eshtërat këtu, në vitin 1968, zymjanët e pagëzuan Shkollën fillore me emrin e tij, pastaj në vitin 1971 këtu themeluan Klubin letrar dhe filluam manifestimin letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Gjeçovit”, por edhe në vitin 2003 filluam ngritjen e këtij amfitetari që e quajtem Kompleksi Përkujtimor “Atë Shtjefën Gjeçovi”, në mënyrë që në këtë amfiteatër të vendosim shtatorën e Atë Shtjefën Gjeçovit, por që më vonë në këtë amfiteatër sipas porosisë së të Madhit Ibrahim Rugova këtu do të vendoset edhe shtatorja e Pjetër Bogdanit e më pastaj edhe të Katarina Josipit e Anton Pashkut, për çka edhe ftojmë të na ndihmojnë në radhë të parë hasjanët e po ashtu edhe institucionet shtetërore të Kosovës e të Shqipërisë. Deri më tash banorët e Zymit, Shëngjergjit, Bregdinit e të disa fshatrave të tjera të Hasit, pa asnjë qindëdark të institucioneve të Kosovës, kanë dhënë afro

200 mijë euro për këtë objekt të kulturës dhe për këtë shtatore, përfundoi Frrok Kristaj.

Në vazhdim Agim Veliu, ministër i arsimit të Kosovës, tha se në emër të Presidentit të Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, sjell këtu në Zym përshëndjet e thella dhe falënderimet e sinqerta për përjetësimin e një figure aq të ndritshme të Rilindjes Kombëtare siç mbetet Atë Shtjefën Gjeçovi, shtatorja e të cilit madhështon jo vetëm Zymin e Hasin, por mbarë Kosovën e shqiptarët.

Ne po përkujtojmë një figure poliedrike të atdhetarit, mësuesit, intelektualit dhe meshtarit që mëltoi dashurinë për dijen, përparimin, gjuhën shqipe dhe pasurinë e vlerave të traditës popullore.

Në kohën kur po mbushen 78 vjet nga koha kur një dorë e zezë ndërpreu në mes jetën e Atë Gjeçovit, Kosova dhe institucionet e saj të dala nga vota e lirë, dinjitetshëm dhe me vendosmëri po ecin drejt procesit që AI dhe Rilindësit tjerë e ideuan.

Imzot Pjetër Bogdani ka thënë se “Fati i popullit tim është edhe fati im”, së këndejmi, edhe sot themi se fati i popullit shqiptar dhe i Kosovës, ishte dhe është fati intelektualëve të Kosovës, fati i autorit të veprës monument, “Kanuni i Lekë Dukagjinit”.

Është përkushtim i përbashkët i institucioneve e qytetarëve të Kosovës, që të realizohet mëvetësia e një kombi autokton, me histori qytetërimi, tradita të lashta dhe vlera të civilizimit euro-perëndimor.

Prandaj mund të themi, sot e këtu në Zym, se Atë Shtjefën Gjeçovi po vjen në këtë amfiteatër bashkë me pavarësinë e Kosovës.

Ju zymjanë të nderuar patët vullnetin dhe mundësitë t’ia ngritni një shtatore madhështore siç ishte Atë Gjeçovi, pishtar i devotshëm i shqiptarizmsë, atdhedashurisë dhe i arsimit e kulturës shqiptare.

Duke përkujtuar veprën dhe jetën e Atë Gjeçovit dhe atdhetarëve tjerë që mbollën dije e arsim në çdo pëllëmbë të vendit tonë, nuk mund të harrojmë se arsimi dhe shkolla shqipe kaluan me vite të tëra në kalvarin e një regjimi shtypës që ishte instaluar dhunshëm për vite me radhë në Kosovë.

Përkundër qindra mësimdhënësve e mija nxënësve që na i mori lufta, përkundër djegies e shkatërrimit të shumë shkollave, vatrave arsimore e fetare, pas luftës e në liri, ndërtoam e rindërtoam bashkë me miqtë tanë ndërkombëtarë shumë shkolla të reja për të ecur pandalshëm drejt ndërtimit të jetës, paqes dhe ardhmërisë, për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Me këtë rast dua t'ju përkujtoj se filozofia politike e kombëtare e Presidentit historik të Kosovës, simbolit të pavarësisë, dr. Ibrahim Rugovës bëri që përmes ndërtimit të sistemit arsimor të pavarur, shkolla shqipe të bëhet shembull ekzemplar i qëndresës dhe mbijetesës.

Filozofinë iluministe të mësuesit e atdhetarit Shtjefën Gjeçovi që përmes dijes dhe arsimimit, e kanë vazhduar breza e personalitet arsimore e fetare, ndërkaq që Qeveria e vendit arsimin e ka shndërruar në prioritet me qëllim që të integrohemi me identitet në proceset moderne të fushës së arsimit dhe familjen europiane.

Atë Gjeçovi, me veprën shumëdimensionale në fushën e teologjisë, të arsimit, arkeologjisë, historisë, etnografisë, mbledhjes, sistemimit e kodifikimit të të drejtave zakonore shqiptare, mbledhjes së folklorit, në fushën e krijimtarisë së prozës e poezisë, si edhe të përkthimeve, mbetet ndër figurat më të ndritshme të shkencës, kulturës, traditës historike e patriotike shqiptare! Shtatorja e Shtjefën Gjeçovit, hyjnisht reflekton dritë, dije e përparim në Kosovën e pavarur.

Në emër të Presidentit të Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, ju përgëzoj për këtë vepër-monument dhe ju qytetarët të Zymit e të Hasit, t'ju falënderoj për këtë përmendore të shenjtë, tha në fund Agim Veliu.

Tani, Agim Veliu, Moikom Zeqo, Nikë Kajtazi e Frrok Kristaj zbuluan shtatorën e Atë Shtjefën Gjeçovit.

Më pastaj, foli edhe Moikom Zeqo, Nikë Kajtazi, Nikollë Kërhanaj, Hilë Prekpalaj, Dr. Don Shan Zefi, Patër Ndue Kajtazi e Sadik Spahija.

Në fund u shfaq një program i pasur kulturo-artistik i ShKA “Katarina Josipi” të Zymit, që ishte përgatitur nga koreografja Lajde Kolëgjera, program ky që u pëlqye shumë nga pjesëmarrësit e këtij manifestimi.

- Legjenda: 1. Agim Veliu, ministër i Arsimit të Kosovës, në emër të Fatmir Sejdiut, kryetar i Kosovës, zbulon shtatoren e Shtjefën Gjeçovit  
2. SHKA “Katarina Josipi” hedhë valle para monumentit të Gjeçovit

## **Nikollë KËRHANAJ**

### **Tradita kulturore e zymjanëve**

Për të arsyetuar kultivimin e traditës shekullore do të shtonim se me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912 edhe Zymi me grupin folklorik të valltarëve të vegjël “Shoqnia e Zymit”, që kishte edhe flamurin me të njejtin mbishkrim mbi shqiponjën dykrenare, kishte marrë pjesë si në programin festiv të organizuar te Vau i Dejës ashtu edhe te Kullat e Lumës, njëherit edhe në Zym. Poashtu, në vazhdim, edhe me rastin e shënimit të njëvjetorit të shpalljes së pavarësisë, më 28 Nëntor 1913, kishin organizuar një program modest kulturor e artistik në Zym, në shenjë të mirënjohjes së pavarësisë të shtetit shqiptar me ç’rast famullitari patër Pashk Prëla, organizoi një solemnitet rasti duke ngitur flamurin e pavarësisë mbi kambonarën e kishës me një predikim rasti.

Këto rrethana dhe të tjerat të mëherëshme krijuan kushtin dhe kërkesën apo mundësinë për riformimin e një shoqërie të cilën e realizuan më 6 dhjetor 1941 por me emër të ri: shoqëria kulturore “Shna Ndou” me kryetar patër Filip Palajn. Ndërmjet vitëve 1941-1944 për çdo manifestim kombëtar, kulturor a fetar qoftë, merrnin pjesë Gjon, Llesh e Pran Shtjefën Kolëndrekaj (edhe ndonjë tjetër bukëpjekës), të cilët përmendnin rastet kur edhe në Prizren kanë defiluar me veshje kombëtare me grupet tjera qytetare nga se këta e kishin dyqanin e bukëpjekësisë në Prizren dhe se kishin marrëdhënie të mira e miqësi me shumë qytetarë në Prizren.

Vitët dhe dekadat kalonin por dëshira për formimin e një shoqërie të tillë nuk shuhej - flinte në shpirtin e artdashësve zymjanë deri më 4 maj 1970, kur me nisjativën e Frrok Kristajt u bë një rilindje kulturore, sidomos me themelimin e SHKA-së me emrin e të madhës aktore Katarina Josipi (Dulaj) nga Zymi, e cila pas SHKA “Agimi” në Prizren, dhe asaj “Emin Duraku” në Zhur, ishte shoqëria e tretë në Komunën e Prizrenit. Pas kësaj, në Has formohen edhe SHKA “Isa Boletini” në Rogovë (25 korrik 1972), SHKA “Malësori” në Gjonaj (1975) e “Bajram Curri” në Ramajë.

Në Hasin e Prizrenit organizohen dy manifestime kulturore-artistike, që janë Manifestimi letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Gjeçovit”, që u themelua prapë me nisjativën e Frrok Kristajt, e të cilin e organizon Klubi letrar “Shtjefën Gjeçovi” në Zym, dhe Festivali folklorik “Hasi jehon”, që e organizon SHKA ”Malësori” në Gjonaj.

### **Babadimri për Vitin e Ri**

*Zym, 31 dhjetor 2007* - Një grup aktivistësh që zakonisht janë të përhershëm në Zym, në mbrëmjen e fundit të vitit në përfundim organizuan grupin e të rinjëve duke u veshur si Babadimrin, në mënyrë që t’u shpërndahen dhurata fëmijëve nga shtëpia në shtëpinë tjetrën. Me atë rast u krijua atmosferë

gëzimi e hareje, por edhe u shijuan të mirat materiale e shëndetësore nga të rinjt dhe të moshuarit. Dhe, mu për këtë organizim shumë fëmijë kurbetçarë nga kurreshtja vijnë enkas në ndërrimin e motive për të qenë të pranishëm me rastin e ardhjes së Vitit të Ri dhe të Babadimrit.

Organizatorë të përhershëm të këtij manifestimi janë: Dr. Lulzim Kolëgjera, Arsim Kërhanaj, Lazër Berisha, Hilë Prekpalaj, Vilson Gërguri, Kolë Pjetër Berisha, Luigj Kolëndrekaj e kurbetçarë të tjerë.

Legjenda: Babadimri u shpërndanë dhurata  
voglushëve zymjanë

### **Trinia e Shenjtë**

*Zym, 17 shkurt 2008* - Pavarësia e Kosovës - shtet i pavarur, sovran e demokratik, mbështetet në katër shtylla kryesore: 1. Gjergj Gjon Kastrioti - Skëndërbeu shtetformues (Besëlidhja e Lezhës apo Kuvendi i Lezhës, 1444), 2. Pavarësia e Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912; dhe 3. Deklarata Kushtetuese (2 korrik 1990), miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Kaçanik, 7 shtator 1990), organizimi i Referendumit në Kosovë (26-30 shtator 1991), veprimi i FARK-ut dhe UÇK-së me ndihmën e forcave të NATO-së (nga 24 marsi 1999 deri me nënshkrimin e marrëveshjes për dorëzim të Sërbisë, më 10 qershor 1999 dhe Rezoluta nr. 1244 e OKB-së. Këto janë Trinia e Shenjtë, që sollën deri te pika 4. Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës - 17 shkurti i vitit 2008.

Për Ditën e Madhe të Pavarësisë, Bashkësia e Lokalitetit të Zymit (me Bregdri) me Shëngjergj, mbajtën dy tubime: më 7 shkurt 2008 kur u formua Këshilli Organizativ me udhëheqës Engjëll Kajtazin, dhe tubimi i dytë, më 12 shkurt 2008, kur u hartua përmbajtja e programit për shënimin e 17 shkurtit (2008) - Ditës së Pavarësisë të Republikës së Kosovës.

Moderatore e programit ishte Greta Dulaj, dhe pas fjalës hyrëse të Engjëll Kajtazit u paraqit SHKA “Katarina Josipi” me një program solemn me folklor e lojëra të vjetra dramatike, këngë dasmash, këngë të kurbetit e valle të përbashkëta me të gjithë pjesëmarrësit.

Programi u shfaq në kompleksin përkujtimor “At Shtjefën Gjeçovi” para shumë pjesëmarrësve. Programin e përgatitën Bibë Berisha, kryetar, dhe Lajde Kolëgjera, korreografe e SHKA “Katarina Josipi” të Zymit. Shpenzimet e manifestimit i siguroi “Fondi për vendlindje”.

*Legjenda: Çast nga festa e zymjanëve kushtuar Pavarësisë së Republikës së Kosovës*

### **Dita e Mësuesit dhe 10-vjetori i epopesë së UÇK-së**

*Zym, 7 mars 2008* - Për shënimin e 7 Marsit - Ditës së Mësuesit dhe 8 Marsit - 10-vjetorit të epopesë së UÇK-së, u organizua një program kulturo-artistik nga Shkolla fillore “Shtjefën Gjeçovi” e Zymit. Programi u shfaq në kompleksin përkujtimor “At Shtjefën Gjeçovi”. Pas fjalës hyrëse “Martirizimi për shkollat shqipe” (referues: Nikollë Kërhanaj) vazhduan paraqitjet: 1. Grupi letrar “Migjeni” (i Shkollës fillore të Zymit) ai recitativ dhe recitali artistik; 2. Mirënjohje dhe dhurata. Drejtorja Komunale e Arsimit në Prizren me këtë rast e laureoi me mirënjohje Nikollë Kërhanajn, dhe të njejtin nxënësit e klasës X-të e XI-të të gjimnazit “Gjon Buzuku”, paralelja në Zym, i dhanë dhurata modeste (dy portrete të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut dhe një portret të Nënë Terezës); 3. Pika folklorike me valle popullore, valle të përpunuara e lojëra të tjera skenike. Programin e përgatitën: Nikollë Kërhanaj, Bedri Çollaku, Bibë Berisha e Marte Kajtazi.

*Legjenda: Marte Kajtazi me nxënësit e saj gjatë një programi kulturo-artistik*

## **Dita e kurbetçarëve**

*Zym*, 24 mars 2008 - Duke u mbështetur nga një traditë e vjetër, e hëna e Pashkëve të Bardha i kushtohej punëtorëve kurbetçarë që çdoherë shënohej në një mënyrë apo tjetër por gjithnjë me një program kulturor e artistiko-argëtues. Edhe në këtë vit u përgatit një program madhështor me një përmbajtje të pasur por të ngushtuar nga moti me shi, gjë që bëri që programi të mbahet në sallën e Shtëpisë së kulturës “Katarina Josipi”, sallë kjo që ishte tepër e ngushtë për t’u bërë vend të gjithë zymjanëve të interesuar për këtë manifestim. Në këtë program solemn, përveç këngëve, valleve të përpunuara, lojërave dramatike, që i përgatitën Bibë Berisha e Lajde Kolëgjeraj, nga Hilë Gjevelekaj u lexua lista e të laureuarëve me mirënjohje të veprimtarëve në fushën e kulturës të këtij mesi.

Do theksuar se në këtë manifestim u përrua edhe vepra më e re e Nikollë Kërhanajt “Zymi i shtatë kodrave I”. Pë veprën e përmendur foli shkrimtari dhe publicisti Frrok Kristaj. Ai me këtë rast ndër të tjera tha se “Nikollë Kërhanaj u lind në Zym të Hasit, më 5 dhjetor 1943. Në Zym kreu shkollën fillore, Normalen në Prizren, ndërsa Fakultetin Filozofik, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, në Prishtinë.

I lindur rrëzë Pashtrikut legjendar, që është i mbushur plot mitologji, Nikollë Kërhanaj sjellë çdo gjë që ka ndodhur në Zym e në fshatrat e Hasit, por i regjistron edhe njerëzit e kësaj toke, që të dijë më shumë dhe që të mos harrojë detajimet dhe situatat duke ndjekur parimin retrospektiv të përkujtimit të kohërave e të bëmave të këtyre anëve”.

Kristaj më pastaj shtoi se “Mënyra e përceptimit të ngjarjeve, sistemi i ndërtimit, që është dokumentar historik e mitologjik dhe raportet ndërmjet tyre, lidhen kuptimisht me pikëvështrimin e tij, që nënkupton funksionalizimin brënda periudhës kohore, brënda rrjedhës kryesore të venerimit, ku dalin në pah vizionet jetësore dhe imazhi njerëzor.

Si shumë krijues të tjerë edhe Nikollë Kërhanaj duke u ndërgjegjësua arriti t'i shikoj rrënjët e tij, që megjithatë ishin të ngulitura në vetëdijen arbërore, ndaj me shprehje të sakta, duke i sjellë gjërat aq afër thjeshtësisë, vite më parë na i dhuroi këto vepra: monografinë “Abetarja e Zymit”, përmbledhjen e poezive “Zana e Pashtrikut”, pastaj monografinë “Zoja e Hasit” (me bashkautor Pater Ndue Kajtazin), fletëpalesën “Zymi i Hasit” (me bashkautor Frrok Kristajn), sikurse edhe monografitë “SHKA “Katarina Josipi” – 1970-2005” (me bashkautor Frrok Kristaj, Shtjefën Dulaj e Hilë Gjevelekaj), “Takimet e Gjeçovit – 1971-2006” (me bashkautor Pater Ndue Kajtazin, Hilë Gjevelekaj e Frrok Kristaj) dhe sot na vjen me monografinë më të re “Zymi i shtatë kodrave”.

Nikollë Kërhanaj i edukuar nga prindërit e urtë, dëgjon ngjarje e epizoda, të cilat i regjistron duke filluar nga personalitetet e figurat e kohës, pastaj veneron dhe regjistron zakonet etnografike e etnogjenetike, besimet, legjendat, mitet e të tjera. Megjithatë, studiuesi Nikollë Kërhanaj assesi të shkëputet nga vendlindja, sepse kjo e bën me të fuqishëm, më të sigurt, ngase këtu e gjen frymëzimin shpirtëror dhe forcën fizike për t'i realizuar synimet në krijimtari.

Nikollë Kërhanaj tash e shumë dekada është i njohur në letrat tona me shkrime të shumta letrare, publicistike, historiografike, etnografike etj. Ai shkroi shtatë vepra me rëndësi të veçantë për letërsinë dhe për historiografinë tonë kombëtare, por këto ditë doli para lexuesve edhe me librin monografik “Zymi i shtatë kodrave”, që tashmë e keni në dorë. Libri është një kaptinë e veçantë monografike për të gjitha ato mbetje etnografike e historike në Zym, të cilat Kërhanaj tash e më shumë se 20 vjet i mbledhë nga kujtesa e mplakur e bashkëfshatarëve tanë. Dhe, sikur të mos delte një kësisoj Nikolle që t'i mbledhte ato copëza etnografike, me siguri se edhe ato do të zhdukeshin, siç janë fshirë edhe shumë të tjera nga kujtesa e më të vjetërve, por edhe jona. Në këtë fushë,

Kërhanaj punoi me vullnet dhe përkushtim të madh dhe kreu një borxh ndaj shumë zakoneve të të parëve tanë dhe zakoneve tona, por edhe regjistroi të gjitha ato personalitete të shquara, që i kontribuan avancimit të jetës, profesionit e mbi të gjitha çështjes fetare, arsimore, kulturore e në përgjithësi çështjes kombëtare. Kërhanaj është njohës i mirë i rrethanave të jetës por edhe i figurave të kohës, që në një mënyrë apo në një tjetër lanë gjurmë. Fundja edhe Bibla na porositi se “jemi të thirrur që të lëjmë gjurmë në këtë jetë”. Ndaj edhe ata që do të shprehin interesim ta lexojnë veprën monografike “Zymi i shtatë kodrave” të Nikollë Kërhanajt, që po e promovojmë sot, këtë do ta bëjnë me një frymë dhe me kënaqësi të veçantë.

Jeta e një krijuesi, siç është Nikollë Kërhanaj, nuk është e rëndomtë: ajo i ka ringjalljet e saj të vazhdueshme e të veçanta. Dhe mbi këto ringjallje të moteve, të valës së kujtimeve e të zjarrit të zgjuar në kujtime, ndriçon Nikolla si kandil i pashuar. Nëpër këto dekada jete, ky njeri i urtë e ka thirrë në një sofër të përbashkët kujtesën kombëtare dhe bashkëkohësinë, traditën dhe modernitetin; pra, ai ecën me ne, pranë nesh e shumë shpesh edhe para nesh.

Dhe, tash kur ndalemi e mendohemi për një çast për shumë ngjarje, tribuna, manifestime, njohje e rinjohje nëpër shumë dekada; do të vërejmë se aty është dora e shpirti i një njeriu pa zhurmë e pa bujë. Aty, tek ajo bukuri e gurtë zymjane, Nikollë Kërhanaj është shkrirë e është bërë një truall i shqipeve midis njerëzve, aty është bërë zjarr i ndjenjës së atdhedashurisë e i shpirtit të traditës, pikërisht në kohët më të rrëshqitshme, kur mund të bjerrej keqas identiteti ynë. Aty, Nikolla me shokë, nuk i lanë të shpërndahen korifejtë e mëdhenj të Hasit që vigjëlojnë amshueshëm në ecjet tona, siç janë emrat e mëdhenj të Imzot Pjetër Bogdanit, të Atë Shtjefën Gjeçovit, të Atë Luigj Palajt, të Katarina Josipit, Anton Pashkut, Gjon Dulajt, Hermina Lekajt e shumë të tjerëve.

Nikollë Kërhanaj në radhë të parë dëshiron dhe synon t'i qëndroj besnik vetvetes. E, t'i qëndrosh besnik vetvetes, nuk do të thotë t'i ruash emocionet, fjalët, mendimet dhe të bëmat, po ta ruash të paprekur e të pashprishur natyrën e vetvetes, ato tipare të karakterit të njeriut të gurtë hasian, ngado që të ketë bredhur; ashtu si shtegtojnë nëpër gjithë dheun vetë zymjanët, por që e ruajnë atë tharm të identitetit të pashprishur. Ashtu, sikundër janë edhe vetë korifenjtë e mëdhenj të Hasit.

I dashuruar që herët në magjinë e traditës, Nikollë Kërhanaj e ruajti frymën e shpirtit të gurtë hasian, të pritjes përtej kufijve njerëzorë, të një singeriteti e krenarie të ruajtur fanatikisht në tharmet e brendshme të shprehjes e të shpirtit duke pushtuar hapësira të reja të identitetit, duke i ngulitur e përhapur këto rrënjë e degë identiteti njerëzor, nacional e krijues. Dhe, së këndejmi, libri i tij që sot e kemi në duar vjen si kurorë e një përvoje të gjatë shkrimore, si thesar e dhunti e kësaj përvoje Nikollë Kërhanaj që aq shumë i ka dhënë këtij mesi e këtij trualli për të mos lënë asgjë në harresë, po për ta ringjallur në shumë forma e trajta deri te ringjallja, siç është edhe sot Festa e Ringjalljes sonë fetare e kombëtare. Kërhanaj është kronist i gjallë e i ngjarjeve të kohës, duke i zënë me penën e tij të hollë të gjitha ato nyje zhvillimore që shënojnë dhe që cilësojnë thelbin e proceseve në kohë dhe hapësirë.

Ndaj, ai është gjithmonë i gatshëm që ta ofrojë shpirtin krijues, si patriot i pedagogjisë shqiptare, me urtinë e hyjnueshme në zemër, ku vazhdon të punojë, veprimtari të jetës kulturore, arsimore e artistike, kurse ditë më parë, përkatësisht më 7 mars – Ditën e Mësuesit edhe institucionet e arsimit të komunës së Prizrenit e laureuan me mirënjohje për punë të palodhshme dhe kontribut dhënë arsimit kombëtar shqiptar”, përfundoi Frrok Kristaj.

Programi u pëlqye nga të pranishmit dhe u kërkuar që të vazhdohet një traditë e tillë kulturore.

- Legjenda: 1. *Furrëtarët zymjanë që nuk e harrojnë vendlindjen: Anton e Mark Kërhanaj, Losh Dedë Prekpalaj e një punëtor kroat*  
2. *Gjokë Kolëndrekaj aktiv në kurbet e në vendlindje (së bashku me një grup zymjanësh)*

### **Në “Hasi jehon” - “Katarina Josipit” vendi i parë**

*Gjonaj, 2, 3 e 4 maj 2008* - Në Kodrën e Pajtimimit në fshatin Gjonaj u mbajt festivali folklorik “Hasi jehon” ku në hapjen e këtij edicioni (të 19-të me radhë) morën pjesë kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ministri i kulturës Valton Beqiri, kryetari i Komunës së Prizrenit, Ramadan Muja, nënkryetari i LDK-së, Eqrem Kryeziu, kryetar i Bashkisë së Krumës, Bardhyl Beka e shumë mysafirë të tjerë, të cilët ia shtuan madhështinë këtij festivali. Si çdo vit, dhe sivjet, në këtë festival mori pjesë edhe SHKA “Katarina Josipi” e Zymit që u prezantua me një program të përsosur e të begatshëm. Është me vend dhe meriton një lavdatë e mirënjohje edhe keroграфи i mirënjohur dhe i papritueshëm Dilaver Kryeziu, i cili u kyq në përgatitjen e programit së bashku me Lajde Kolëgjerajn e të tjerët.

Në mbrëmjen finale, të mbajtur më 4 maj 2008, sipas vendimit unanimit të jurisë profesionale (në përbërje Sami Piraj, Dilaver Kryeziu, Esat Ruka, Xheladin Kastrati dhe Muhamet Lushaj), SHKA “Katarina Josipi” e Zymit zuri vendin e parë dhe iu nda çmimi “Malësori”.

Konstatim i përgjithshëm është fakti se festivali “Hasi jehon” është një dasmë e vërtetë për të gjithë hasjanët.

### **“Katarina Josipit” – vendi i dytë**

*Bajram Curr, 12 qershor 2008* - Në festivalin folklorik “Sofra dardane”, që u organizua nga Unioni Artistik i Kombit Shqiptar, mbajtur për të gjashtë herë me radhë në Bajram Curr - Tropojë, morën pjesë mbi 40 shoqëri e ansamble kulturore-

artistike nga mbarë viset etnike shqiptare. Në këtë festival u prezantua edhe SHKA “Katarina Josipi” nga Zymi me një program të pasur e të ngjeshur folklorik.

Festivalit i parapriu parakalimi i ansambleve nëpër qytet në ballë të cilave printe SHKA “Katarina Josipi” nën përcjelljen e së cilës ishte Deli Metaliaj, udhëheqës artistik e valltar i talentuar. Në përmbajtjen e programeve vetëm SHKA “Katarina Josipi” e Zymit e prirë nga Bibë Berisha e Lajde Kolëgjera, përveç valleve burimore, paraqitën edhe rite e lojëra të ndryshme dramatike, që i përgjigjen këtij Festivali, të cilat kanë filluar të zhduken. Në ditën e fundit të Festivalit, juria profesionale vendosi që vendin e dytë t’ia jep SHKA-së “Katarina Josipi” për shoqëri më komplete dhe se programi i përgjigjej fizionomisë së Festivalit Folklorik.

Legjenda: *SHKA “Katarina Josipi” e Zymit në Bajram Curr*

### **Në Zym - komandanti i KFOR-it**

*Zym, 13 korrik 2008* - Me paralajmërimin se komandanti i KFOR-it të Kosovës, gjenerali Ksavier de Marnak (francez) do të vijë për një blic-vizitë në Zym, SHKA “Katarina Josipi” bëri një përgatitje solide me anëtarët e shoqërisë dhe e pritën solemnisht madhërinë e Tij që të njihet me kostumografinë dhe kërkesat e zymjanëve. Çka don të thotë se kjo shoqëri është e gatshme për t’iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të vendit.

Legjenda: *Komandanti i KFOR-it, gjenerali Marnak, në mesin e zymjanëve*

### **Binjakëzimi i Zymit me Emdenin e Gjermanisë**

*Zym, 31 gusht 2008* - Në nivel të Kosovës, përveç shumë OJQ-ve, është themeluar dhe vepron edhe Shoqata “Kolping-Kosovë”, kryetar i së cilës është Nikollë Kërhanaj. Kjo Shoqatë i ka Kolping-Familjet nëpër shumicën e Famullive në Kosovë

dhe në Shqipëri. Në Zym vepron Familja Kolping me kryetare, Lajde Kolëgjeraj.

Gjatë punës në këtë veprimtari është binjakëzuar Familja-Kolping e Zymit me atë të Emdenit të Gjermanisë, që bëjnë vizita reciproke Zym-Emden e anasjelltas. Edhe sivjet, nga Emdeni kanë ardhur mysafirë, të cilët janë pritur zemërhapur nga disa familje të Zymit, por edhe nga famullitari i Zymit, Dr. Don Shan Zefi.

Legjenda: *Mysafirët e Emdenit të Gjermanisë në mesin e zymjanëve*

### **“Katarina Josipi” në “Gjurmë të Perandorit Justinian”**

Orllan (Podujevë), 13 shtator 2008 - Sivjet për të parën herë u organizua manifestimi dyditësh “Gjurmë të Perandorit Justinian”, të cilin e organizoi Shoqata Kulturore e Kosovës “Anton Pashku” në Prishtinë në bashkorganizim me shoqatën “Gallapi” dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit si dhe Drejtoratin e Arsimit e Kulturës të komunës së Prishtinës. Ideator dhe kryetar i Këshillit Organizativ i këtij manifestimi ishte veprimtari i kulturës, Frrok Kristaj.

Gjatë ditës së parë të këtij manifestimi në Prishtinë u mbajt simpoziumi shkencor kushtuar Perandorit Justinian, që e udhëhoqi Frrok Kristaj e ku u paraqiten nentë kumtesa shkencore nga shkençarët dhe historianët më eminent të Kosovës. Ndërkaq, ditën e dytë, në pjesën artistike të programit, që u mbajt në Orllan të komunës së Podujevës, u paraqit SHKA “Katarina Josipi” nga Zymi me valle e lojëra nda tradita e vendit. Programi folklorik-artistik i kënaqi të pranishmit duke iu bashkuar që të gjithë në valle të përbashkët vëllazërore.

Legjenda: *“Katarina Josipi” e Zymit në manifestimin “Gjurmëve të Perandorit Justinian”*

### **KFOR-i italian pajisë me inventar Shkollën e Zymit**

*Zym, 18 shtator 2008* – Kërkesës së Shkollës fillore “Shtjefën Gjeçovi” për të siguruar inventar të nevojshëm, nga drejtori Arsim Kërhanaj, iu përgjigj KFOR-i italian (karabinieria italiane), me komandantin kolonel i karabinierisë G-9 në Prishtinë CIMIC, dhe ai francez për paisjen e shkollës së Zymit me inventar shkollor nga Marshal Tajeti, furnizues i mjeteve Mouglass: banga, karriga, rafte për këpucë të nxënësve, stufa (11 sosh), një kabinet me 8 kompjuterë e karriga si dhe një aparat fotokopjues.

Në pritjen që iu bë me rastin e pranimit dhe nënshkrimit të ndihmës, SHKA “Katarina Josipi” me anëtarët e vet bëri një pritje dhe përcjellje solemne, që u la përshtypje të jashtëzakonshme donatorëve italianë. Ishte kjo një formë falenderimi e mirënjohje për kujdesin që brezat e reja të edukohen në kushte më të mira e bashkëkohore.

Dreka e përbashkët me arsimtarët ishte në frymën e punës, ndërsa pjesa artistike e shoqërisë i fascionoi mysafirët - pjesëtarët e KFOR-it.

Bashkangjitur kësaj, të shënojmë edhe ndihmën që e bëri Drejtoria Komunale e Arsimit dhe e Kulturës (sektori teknik) i komunës së Prizrenit për shtruarjen e oborrit të Shkollës së Zymit me katrorë betoni dhe rrethojën e jashtme me pritka të metalta, për çka të gjithë zymjanët u janë mirënjohës. Edhe fshati, murit të oborrit të shkollës do t’ia bëjë një shallon betoni, për të marrë pamjen meritore ambienti shkollor.

*Legjenda: Pjesëtarët e KFOR-it italian, që pajisën me inventar Shkollën e Zymit, në mesin e zymjanëve*

### **Frrok Kristajt – çmimi “Akil Koci”**

*Stubëll e Epërme, 27 shtator 2008* - Në Stubëll të Epërme të komunës së Vitisë, më 27 shtator (2008) u mbajt edicioni i 19 i

manifestimit letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Don Mikelit”. Në këtë manifestim të sivjetmë, që ishte shumë i suksesshëm, përveç tjerash Frrok Kristaj u shpërblye me mirënjohjen “Akil Koci”, që në emër të kompozitorit Akil Koci, ia dorëzoi Don Aleksandër Kola, famullitar i Stubllës. Ky çmim iu dha shkrimtarit e publicistit Frrok Kristaj për kontributin e dhënë zhvillimit të kulturës shqiptare në Republikën e Kosovës. Do përmendur se Frrok Kristaj përveç që është autor i më shumë se 15 veprave letrare, publicistike e pedagogjike, ai ka themeluar SHKA “Katarina Josipi”, Klubin letrar “Shtjefën Gjeçovi”, manifestimin letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Gjeçovit”, Festivalin kulturor rajonal “Hasi” e revistën informative-letrare “Zëri i Hasit”, të gjitha në Zym të Hasit, pastaj Kampionatin e diturisë (kuizin) të shkollave me mësim plotësues në gjuhën shqipe në Gjermani e revistën informative, kulturore e letrare “Kosovari” në Hamburg të Gjermanisë, Manifestimin kulturor e shkencor “Ditët përkujtimore Nëna Tereze” në Prishtinë, manifestimin letrar e kulturor “Gjurmë të Gjeçovit” në Janjevë të Lipjanit dhe manifestimin shkencor e kulturor “Gjurmët e Perandorit Justinian” në Prishtinë e Orllan.

### **Fondi për studentë të dalluar**

*Zym, shtator 2008* - Klubi letrar “Shtjefën Gjeçovi” ishte dhe është prijëtar i shumë ideve, projekteve dhe nismave për t’i realizuar kërkesat e banorëve dhe në përgjithësi të fashatit Zym. Ndaj, nga veprimtaria e SHKA “Katarina Josipi” dhe e Klubit letrar “Shtjefën Gjeçovi”, ditë më parë u lind idea (nga veprimtarët e dalluar Nokë P. Lekaj e Kolë N. Prekpalaj), që të themelohet një fond i veçantë që do t’i dedikohet këtyre shoqatave qytetare që e realizojnë veprimtarinë me sukses, si dhe një fond solidar dedikuar studentëve të dalluar.

Në realizimin e të gjitha këtyre veprimtarive kulturore-publike, nismave të mirëfillta, ndërtimeve, rregullimit të ambientit

jetësor në fshat, në shkollë, në kishë dhe përgjithësisht në veprimtaritë shoqërore-publike e politike në Zym, më të merituarit janë veprimtarët: Frrok Kristaj, Lajde Kolëgjera, Nokë P. Lekaj, Kolë N. Prekpalaj, Nikollë Kërhanaj, Hilë Gjevelekaj, Mihill Preklushaj, Gjokë Kolëndrekaj dhe të gjithë ata që ndihmojnë Fondin e vendlindjes.

Prezantime

## **Frrok KRISTAJ**

### **Abetarja e Zymit dhe Kongresi i Manastirit**

*Më vrisni, por lejoni që t'u shërbej gjaku im për ngjyrë që t'i shkruani shkronjat e alfabetit shqip – Nino Luarasi*

Më 18 maj 1854, gjermani Franz Bopp, kur në Akademinë e Shkencave të Berlinit mbajti kumtesën me titull "Mbi shqipen në lidhjet e saj të afrië", argumentoi se gjuha shqipe i përket gjuhëve indeoevropiane. Atëbotë "Ëvetari shqip..." i Naum Veqilharxhit kishte plot dhjetë vjet që kur ishte botuar.

Abetaret qenë armë nga më të fuqishmet dhe nga më të efektshmet për të shkëputur arsimin tonë nga varësia e shkollave të huaja. Me përmbajtjen e tyre ato ndikuan fuqishëm në edukimin e brezave të tërë me ndjenjat më të larta atdhetare. Por abetaret do t'i kishin dyert të mbyllura dhe shtigjet të zëna, në qoftë se nuk do të kishin mbrojtjen me armë nga luftëtarët shqiptarë. Nga kjo del se abetaren shqipe e ruajti pushka. Pushka i jepte forcë abetares - abetarja i jepte krismë pushkës. Shumica e autorëve të abetareve shqipe qenë njëkohësisht pedagogë e luftëtarë, shkencëtarë dhe veprimtarë të Lëvizjes Kombëtare, tekstologë dhe organizatorë të arsimit. Një pjesë e tyre ranë dëshmorë për idealin e tyre për çlirimin kombëtar, për të mbijetuarit e gjuhës shqipe. Të tillë kanë qenë Naum

Veqilharxhi, Anastas Kullurioti, Luigj Gurakuqi, Jashar Erebara, Shefqet Daiu e shumë të tjerë.

Dhe, asnjë tekst mësimor si Abetarja, për një kohë kaq të gjatë nuk është lidhur aq ngushtë me historinë e arsimit dhe të kulturës shqiptare. Kjo, padyshim, është rrjedhojë e funksionit shumëplanësh që abetarja luajti për më se 164 vjet nga abetarja e parë shqipe.

Me këtë tekst nuk u lidhën vetëm mësimdhënësit, por edhe njerëz të fushave të tjera, si mendimtarë, politikanë, ideologë, luftëtarë, ithtarë të Lëvizjes sonë Kombëtare, dyqanxhinj, udhëtarë etj., të cilët, në çantat e tyre, krahas armës, mbanin edhe abetaret për t'i shpërndarë që të mësohej gjuha shqipe, gjuha e mëmës, për të përgatitur më vonë njerëz të ditur. Me asnjë libër tjetër si me abetaren nuk e lidhën jetën dhe fatin e tyre shumë autorë, tipografë, redaktorë, shpërndarës, doganierë, librarë, mësues dhe atdhetarë, të cilët e bënë këtë në emër të idealit të pavarësisë së trojeve shqiptare.

Abetarja shqipe për shumë vjet u vu në listat e zeza të botimeve të ndaluara. Autorin e "Ëvetares..." së parë e helmuan, kurse kopjet e këtij "libri të mallkuar", që kishte marrë udhët e Evropës, i dogjën. Rruga e abetares ishte plot rreziqe dhe e pandarë nga lufta për çlirimin e atdheut.

Për ta mbajtur gjallë abetaren shqipe, derdhën mund e djersë penat më të fuqishme të kohës, si N. Veqilharxhi, K. Kristoforidhi, D. Boriçi, S. Frashëri, J. Vreto, K. Hoxhi, P. Vasa, A. Kullurioti, L. Gurakuqi, P. Qiriazi, N. Lako, S. Shuteriqi, A. Xhuvani, N. Paluca, Th. Papapano, J. Minga, M. Logoreci, G. Beltoja, L. Skendo, L. Lumezi, Q. Guranjaku, K. Xhumari, Q. Batalli, M. Gjevori, Gj. Gjokaj, Xh. Gega etj.

Abetarja, si asnjë libër tjetër shqip, depërtoi në burgje, u fut në shpella, u mësua në natyrë nën qiellin e hapët dhe në odat e tymta. Ajo mëkoi dashurinë për gjuhën mëmë, ku shpërthente zemra për lirinë.

Historia e abetareve është e lidhur ngusht me historinë e shkollës kombëtare shqiptare. Abetarja krijoi mundësinë e zhvillimit të arsimit shqip në shkollë dhe njëkohësisht u hapi rrugë teksteve të tjera shkollore.

Siç është vënë re, abetarja shqipe përse i përket vendeve të botimit ka pasur një shtrirje të gjerë gjeografike. Ajo është shtypur jashtë dhe brenda territoreve shqiptare, si në Bukuresht, Sofje, Stamboll, Athinë, Napoli, Manastir, Bruksel, Paris, Worçester, Kajro, Aleksandri, Shkodër, Zym, Kumanovë, Tiranë, Prizren, Prishtinë, Korçë, Vlorë, Shkup etj. Abetarja jonë është përdorur në të gjitha trevat shqiptare dhe në diasporën shqiptare.

Nxënësit shqiptarë, duke mësuar të shkruajnë dhe të lexojnë në këtë gjuhë, u njohën edhe me historinë e kombit. Abetarja ndihmoi në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve, dhe, në çfarëdo forme që janë botuar, gjithnjë kanë pasur karakter funksional. Në këtë pikëpamje, ato përherë janë pasuruar dhe përsosur, duke dhënë kështu një ndihmesë në historinë e kulturës shqiptare. Një përfundim tjetër i rëndësishëm është edhe roli që kanë luajtur abetaret në unifikimin e gjuhës së përbashkët dhe në hedhjen e bazave të gjuhës letrare.

Në ato kushte, shoqëria “Bashkimi” e Manastirit, më 14 Nëntor 1908, thirri Kongresin e parë të përgjithshëm për krijimin dhe miratimin e nje alfabeti të njësuar. Në atë Kongres morën pjesë 150 delegatë të ardhur nga të gjitha viset shqiptare dhe nga bashkësitë shqiptare nëpër botë, por kishte edhe mysafirë.

Kongresi nëntëditor vendosi me votë të plotë që shqiptarët të linin mënjandë alfabetin e Stambollit me dhjetë shenjat e tij të veçanta dhe ta shkruanin gjuhën e tyre vetëm me alfabetin latin. Alfabeti i hartuar në Manastir përmbante 36 shkronja e ndërthurje shkronjash latine.

Do theksuar se me miratimin e alfabetit të gjuhës shqipe në Kongresin e Manastirit, por edhe me ngritjen e Shtypshkronjës

Shqipe, po ashtu në Manastir, që mundësoi botimin dhe shpërndarjen e librave e gazetave në gjuhën shqipe, u krijua disponim i gjerë për të shpërthyer shqiptarizma.

Kongresit të Manastirit, në vitin 1908, dhe hapjes së shkollave shqipe i paraprinë dhe e nxitën rilindasit, patriotët dhe veprimtarët e kulturës, ata që kishin të bëjnë me popullin dhe shkrimin shqip. Ata qenë të shtyrë ta ruajnë origjinalitetin e theksit të të folurit të mjedisit, me të cilin kishin të bëjnë. Madje, ata, për t'i mbetur besnik aspektit fonetik të të folmes lokale dhe të shqipes në përgjithësi, secili prej tyre ishte i detyruar të krijojë shenja të veçanta për t'i shënuar tingujt e të folmës shqipe, ose detyroheshin të merrnin grafema të gatshme të autorëve të mëparmë apo edhe të huazonin nga alfabetet tjera, të cilat i modifikonin. Dhe, gati-gati, asnjëri prej tyre nuk përdori shenja të njejta për t'i shënuar tingujt karakteristikë të gjuhës shqipe.

Sipas shënimeve të evidencuara me rastin e pagëzimit të fëmijëve, të kurorëzimeve, vdekjeve apo lëshimit të dëshmimeve të ndryshme, që kanë lënë meshtarët e devotshëm, që shërbyen në Zym, sidomos ata të fundit të shekullit XIX e deri në kohën kur u mbajt Kongresi i Alfabetit, del se ata kanë përdorur një varg shenjash grafike, të cilat ose i kanë krijuar vetë ose i kanë huazuar nga shkrimtarët e vjetër. Sa për ta ilustruar këtë që u pohua më lart, do të përmendim se duke që sa më origjinal t'i evidencojnë shënimet e nevojshme, për t'iu përmbajtur theksit të të folurit vendor, ata përdorën grafikisht gjatësinë e zanoreve me anë të geminacionit, si bie fjala në vend Pal e shkruanin Paal, Matë – Maatë, Kolë – Koolë, Rrafë – Rraafë, Ndokë – Ndookë, Getë – Geetë, Mihill – Mihiill, pastaj Gega - Ghegha e kështu me radhë.

Shembujt e përmendur janë disa nga shkronjat që janë përdorur nga meshtarët e Zymit para se të hynte në përdorim Abetarja e Zymit. Megjiathtë, sipas Shefik Osmanit, del se në Arkivin Qendror të Republikës së Shqipërisë (Kolekcioni i fondit

personal i Jakut të Tushit Mark Krajës, alias Jak Specit, Dosja numër 163, ekziston “ABETARJA E ZYMIT, 20 maj 1900”, që ka 80 faqe, por që i mungojnë kopertinat). Supozohet se kjo Abetare është litografuar (shtypur) pikërisht në Zym dhe se autor i saj mendohet të ketë qenë Lazër Lumezi (në këtë Abetare në vend të fjalës mësues përdorët fjala shkollar, që është shumë e përafërt me atë se Lazër Lumezi ishte autor, pasi që ai njihej edhe si Lazër – shkollari), përkatësisht Mati Logoreci apo Dedë Pasi. Ka edhe mendime se ky tekst elementar është hartuar nga një grup mësuesish nga rajoni i Prizrenit. Abetarja e Zymit nuk e ka të shënuar emrin e autorit apo shtëpinë botuese, që mund të jetë edhe ajo se në atë kohë tekstet e tilla në gjuhën shqipe ishin të ndaluara, ndaj për t’iu shmangur ndjekjeve të pushtuesit dhe ndjekjeve kishtarë të sllavëve apo grekëve, shpesh autorët vinin sigla të ndryshme ose pranonin të mbetnin anonimë, se ata ishin të kënaqur se ia arrinin qëllimit të caktuar.

Në kohën para dhe pas përdorimit të kësaj Abetare në Zym kishin shërbyer në detyrën e mësuesit në radhë të parë meshtarët: Shtjefën Krasniqi, Pjetër Battisti, Pjetër Pecolli (zymjanë), Franë Koliqi, pastaj mendohet se në Zym të ketë qenë mësues edhe Lazër Lumezi, po ashtu nga ky fshat.

Përndryshe, Abetarja e Zymit është e hartuar me alfabetin e Stambollit, pra me një gjuhë të vështirë e të vjetër të veriorëve dhe se alfabeti i saj nuk është gjithaq praktik për mësimin e gjuhës shqipe. Megjithatë, ky alfabet në këtë Abetare ka 33 shkronja dhe se shkronja Ë nuk përfaqësohet fare, pastaj për Q përdorët C, si dhe përdorët vetëm një Q (pra edhe për Ç), përkatësisht një GJ (edhe për XH) - gami për xhami, që në pjesët veriore të viseve shqiptare, edhe ashtu pak apo aspak në të shqiptuar e të folur nuk hetohen dy tinguj për këto shkronja, e kështu me radhë. Sido që të jetë, Abetarja e Zymit i ruan vlerat e saj historiko-arsimore e gjuhësore, për rolin që luajti në Zym, përkatësisht në rajonin e Hasit, për shkrimin e leximin e

gjuhës shqipe, sepse ajo i ka vlerat e veta pedagogjike e historike. Ajo paraqet një dëshmi të qartë për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe në kushtet e pushtimit osman në periudhën pas Lidhjes së Prizrenit dhe të Pavarësisë së Shqipërisë, si dhe për frymën patriotike që kishte procesi mësimor dhe tekstet e përgatitura nga kuadrot vendore, e sidomos ata që njëherësh ishin meshtarë, por që edhe e mbanin gjallë shkollën dhe gjuhën shqipe në Zym të Hasit të Thatë dhe më gjerë.

Megjithatë, duhet theksuar se për shumë shkronja alfabeti i Abetares së Zymit përdorë shenja grafike ndryshe nga ato të Kongresit të Manastirit. Mirëpo, sikur të mos ishte hartuar një alfabet i përbashkët në Kongresin e Manastirit, vallë, sa lloj abetaresh apo tekstesh mësimore do të përdornim ne sot?

Sido që të jetë, gjatë zhvillimit të letërsisë shqipe u hartuan disa alfabete të ndryshme. Një nga më të fundit ishte ai i krijuar në Stamboll. Megjithatë, mendimi i përgjithshëm ishte se shkronjat jolatine nuk ishin aspak të pranueshme për krijimin e letërsisë shqipe dhe gjuhës kombëtare shqipe. Për këtë arsye, shoqëria aktive dhe idealiste "Bashkimi" në Manastir, kishte organizuar Kongresin e Parë të Përgjithshëm për krijimin e një alfabeti të njësuar. Një alfabet i njësuar do të ishte edhe fillimi i letërsisë së mbarë shqiptare.

Do theksuar se para Kongresit të Manastirit, gjuha shqipe ishte shkruar me shkronja arabe, greke, sllave, apo me përshtatjet e tyre. Mirëpo, vendosmëria e delegatëve të Kongresit të Manastirit, për t'i kthyer sytë nga perëndimi, ishte shpallje kulturore e pavarësisë, gjë që nuk kaloi pa u vënë re as nga qeveria turke e as nga kisha ortodokse greke dhe aleatët e tyre sllavë.

Meritat më të mëdha për bashkimin e alfabeteve pa tjetër se i pat Klubi "Bashkimi", por ai që e nxiti edhe më tepër punën, del se ishte Gjergj Fishta. Kjo vërehet kur ai paraqitet në foltore para të gjithëve me fjalët "S'kam ardhur që të të mbroj

asnjë alfabet, por, të mbroj një alfabet të përbashkët”. Pra, ai tregoi se nuk kishte ardhur për të përçarë por për të bashkuar. Dhe ai që e kuptoi dhe që e ndjeu vlerën e këtyre fjalëve e përmbajti edhe një alfabet të përbashkët. Nuk ishte gjë e rastit kur një nga të pranishmit, përkatësisht kleriku mysliman, Ibrahim Efendiu, del në foltore dhe me lot në sy e përqafoi Gjergj Fishtën duke e kuptuar rëndësinë e fjalëve të tij.

Dhe, çfarë mendimi do të kishte për ne sot bota sikur do ta përdonim alfabetin arab? Alfabeti latin i shqipës dhe braktisja e alfabeteve arabe, cirilike apo greke, ishte dëshmi se shqiptarët që atëherë po e shquanin prirjen e tyre properëndimore dhe identitetin e tyre evropian. Ndaj, me krijimin e një alfabeti të njësuar e të mbështetur në alfabetin latin, u përforcua edhe teza për lashtësinë e gjuhës shqipe, e cila është vërtetuar në Institutin e Gjuhëve në Zvicër, ku në mënyrë figurative, në formë të një druri, gjuha shqipe e mban vendin e rrënjës.

*(Kumtesë e paraqitur në simpoziumin kushtuar 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit, të mbajtur në Zagreb, më 12 prill 2008)*

## **Frrok KRISTAJ**

### **Kati – atdhetare dhe primadonë e teatrit**

*Njëzet e një vjet me radhë, aq sa jetoi Katarina Josipi - Kati, në skenën e Teatrit profesionist të Prishtinës, ajo ishte kampione, bartëse e roleve më komplekse të repertoarit më të shumëllojshëm. Bukuria e brendshme e Katit shpërthente vetëm kur fikeshin dritat në sallë e ndizeshin të tjerat në skenë. Atëherë temperamenti i saj artistik i magjepste dhe i çonte shikuesit në një tjetër jetë*

Katë Dulaj, apo siç njihet me emrin artistik Katarina Josipi, Kati jonë e madhe, u lind në fshatin Zym të Hasit, komuna e Prizrenit, pikërisht më 9 nëntor të vitit 1923, e jo siç figuron aty-këtu nëpër disa dokumente me të cilat janë shërbyer disa institucione teatrore se Kati u lind më 19 nëntor 1923. Ajo më 19 nëntor (1923) është pagëzuar në Kishën e Zymit.

Katë Dulaj ishte e bija e Gjini dhe e Gjystit (Prekpalaj) Dulajt. Ishin katër fëmijë - Marku, Lazri, Kata e Pali. Prindërit Katës emrin ia dhanë në bazë të festës së Shën Katarinës së Aleksandrisë, pajtore e Kishës në Pejë (kremtohet më 25 nëntor), por edhe festë familjare e dajëve të Katës - Prekpalajt. Përndryshe, Kata me vëllezër është brezi i 10 i familjes Berisha të ardhur nga Tropoja (Shqipëri) dhe të vendosur në Zym. Në fakt, i pari i lagjës Berishë (në Zym), që erdhi nga Tropoja quhej Peci, e më pastaj vijnë brezet: Pjetri i Pecit, Ndreka Pjetri, Mark Ndreka, Gegë Marku, Ndue Gega, Pjetër Ndou, Jozë Pjetri, Gjini Joza dhe Kata Dulaj alias Katarina Josipi.

Katarina Josipi shkollimin fillor e nisi në Zym në gjuhën serbe pas vrasjes së Atë Shtjefën Gjeçovit, kurse e kreu në Nish (tash në Serbi) ku ishte me babain e vet bukëpjekës. Atje e kishte kryer edhe shkollën e natës për rrobaqepëse. Pas bombardimit të Nishit, në prill të vitit 1941, babai i Katit, sikurse shumë bukëpjekës të tjerë nga Zymi, kishin ikur nga Nishi, kurse babai i Katit, Gjini Joza, ishte vendosur në Ferizaj.

Katarina Josipi si aktore amatore kishte hapëruar në dërrasat e Teatrit Amator në Ferizaj, së bashku me Shaban Gashin e Matej Serreqin, që të dy po ashtu nga Ferizaji.

Ishte mbarimi i vitit 1947, kur për herë të parë në Prishtinë po hapej teatri profesional. Ndërkaq, në pranverë të vitit 1948 në këtë teatër u angazhuan Katarina Josipi, Hyrije Hana e Meribane Shala, që njëherësh ishin tri femrat e para shqiptare të këtij teatri.

Shfaqja e parë, apo siç është bërë zakon të thuhet - premiera e parë në këtë teatër u realizua më 1 maj 1949, me pjesën

"Personi i dyshimtë", të autorit serb Branislav Nushiq, i cili në vitet e mëhershme kishte shërbyer si konzull serb në Prishtinë. Në Teatrin profesional të Prishtinës Katarina Josipi aktroi plot 21 vjet.

Dhe, po aty, në Prishtinë, më 29 prill 1969 vdiq në moshën 46-vjeçare, si për çudi prapë në ditën e festës së Shën Katarinës së Sienës (kremtohet më 29 prill), kurse u varros atje edhe nga erdhi - në Shëngjergj, afër Zymit të Hasit të Thatë, pranë meshtarit e patriotit Atë Luigj Palaj, që e masakruan (më 7 mars 1913) serbo-malazet për shkak se nuk lejoi që shqiptarët të kalojnë në ortodoksizmin serb dhe pranë figurës së madhe poliedrike të kulturës shqiptare - Atë Shtjefën Gjeçovit, që e vranë serbët më 14 tetor 1929. U varros në oborrin e Kishës së Shën Prenës në Shëngjergj, ku pas 26 vjetësh, pra iu bashkua edhe bashkëvendësi i Katit, e shkrimtari më i njohur i prozës moderne në letërsinë shqipe - Anton Pashku e tash së voni në ato varreza u varros (më 21 nëntor 2007) edhe mezosopranja e njohur Hermina Lekaj.

Kati - bareshë dhe ministreshë

Katarina Josipin - Katin e kemi parë në skenën e teatrit profesional, e kemi dëgjuar në radio me radiodrama, por e kemi parë edhe në televizion e në film. Megjithatë, ajo jetoi në skenën teatrore, aty ku e fillonte jetën magjepëse që e sheh, e ndien, ku i zbulonte karakteret e njerëzve, rolet e të cilëve i interpretonte. Ishte prijëtare e dramës shqipe. Jeta e Katit ka filluar kur janë ndezur dritat e skenës. Aty derdhi djersën e vet. Në skenë ajo jeton edhe sot pas 39-vjetëve të kalimit të saj në amshim. Jeton në kujtimet e artistëve, por edhe të shikuesve e të dashamirëve të teatrit.

Njëzet e një vjet me radhë, aq sa jetoi në skenën e Teatrit profesionist të Prishtinës, Kati ishte kampione, bartëse e roleve më komplekse të repertoarit më të shumëllojshëm të teatrit tonë. Bukuria e brendshme e Katit shpërthente vetëm kur fikeshin dritat në sallë e ndizeshin të tjerat në skenë. Atëherë

temperamenti i saj artistik i magjepste dhe i çonte shikuesit në një tjetër jetë.

Për Katin ishte njësoj me rëndësi roli kryesor, i mesëm apo episodik. Të gjitha i interpretonte me pasionin më të madh, me përkushtim, duke e shkrië vetën në role, duke përjetuar dhe duke krijuar fytyra të reja, karaktere të reja. Për Katin, po ashtu, ishte njësoj kur interpretonte role nga dramat origjinale apo të përkthyer, dramat klasike apo bashkëkohëse.

Kati me invencion të rrallë interpretonte bareshën dhe ministreshën. Kishte aftësi transformimi. Mishërohej thellësisht me personazhet që i interpretonte. Identifikohej me fatet e tyre dhe ua zbulonte karakteret. Pra, Katarina Josipi me talentin e saj të një artisteje të parë dhe të madhe, ngriti një galeri të tërë tipesh që e ndien jetën pa kufi, kohë e hapësirë. Dhe, vërtet është vështirë tash të bëjmë ndonjë shëtitje nëpër ato 73 e sa role që i interpretoi gjatë jetës së saj edhe ashtu të shkurtër.

Për 21 vjet interpretoi më se 73 role

Gjatë 21 vjetëve sa punoi në Teatrin profesional të Prishtinës, luajti me Nexhmije Pagarushën, Bekim Fehmiun, Muharrem Qenën, Hyrie Hanën, Istref Begollin, Xhevat Qenën, Shani Pallaskën, Malo Gamin, Ragip Loxhën, Kristë Berishën, Matej Serreqin, Shaban Gashin, Abdylrahman Shalën, Melihate Ajetin, Leze Qenën, Meribane Shalën, Adelajde Sopin, Belxhyzare Fejzën, Qazim Dushkun, Luba Tadiqin, Naxhie Devën, Masar Kadiun, Xhevdet Lilën, Ahmet Spahiun, Ahmet Qirezin, Mysherefe Prekën, Ekrem Kryeziun, Basri Çitakun, Bajram Pakashticën, Zymber Statovcin, Shaban Domin, Gani Jetishin, Vera Balajn, Mikel Balajn, Riza Tarakun, Adem Mikullovcin, Dibran Tahirin, Selman Lokajn, Arif Valën, Safete Rogovën e shumë e shumë të tjerë.

Kati ishte në gjendje të krijonte fytyra komplekse, madje edhe atëherë kur nuk ishin të kompletuara nga autori apo regjia. Në mënyrë shumë të natyrshme e bindëse Kati rolet që i

interpretonte, mbanin vulën e kohës, të ambientit dhe të kushteve në të cilat edhe vetë ishte formuar.

Katarina Josipi - Kati për kontributin e saj, por edhe për rezultatet e arritura mori shumë herë shpërblime e mirënjohje që i jepnin atëbotë institucionet profesioniste. Në veçanti po përmendim se ajo ishte laurate e Shpërblimit të Dhjetorit të vitit 1958 të Kuvendit të Kosovës, që ishte sinonim i vendimeve të Bujanës, ku ishte vendosur që pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova t'i bashkohej Shqipërisë.

Kati - anëtare e NDSH-së

Në fakt, pasi ishte kthyer familja e Katit nga Nishi në Ferizaj, vëllai i saj Lazri, që në vitin 1945 ishte nxënës i Gjon Serreqit në Gjymnazin e Prishtinës, edhe Kati bashk me vëllain e vet ishte angazhuar në Organizatën Nacional Demokratike Shqiptare. Bile, NDSH-ja kishte nevojë shumë të madhe pikërisht për femra, sepse ato i nevojiteshin për bartje të postës, mbledhjes dhe shpërndarjes së ndihmave, sidomos për familjet e të pushkatuarëve, të burgosurëve, të atyre që gjendeshin nëpër male, si dhe për shpërndarjen e afisheve e të trakteve nëpër vendbanime të ndryshme.

Organet e ndjekjes së pushtetit okupator kah gjysma e dytë e vitit 1945 kishin shtuar aktivitetin e tyre. Bile, sipas të dhënave të kohës, organet e ndjekjes kishin arritur t'i zhduknin 15 dhe t'i plagosnin 12 aktivistë të rëndësishëm të grupeve të armatosura të NDSH-së, të cilët bënin rezistencë kundër okupatorit. Po ashtu njësit policore e ushtarake të okupatorit pothuaj se çdo ditë arrestonin anëtarë të devotshëm të NDSH-së. Gjatë viteve 1945-1948, gjyqet ushtarake e ato civile të okupatorit në Prizren, Prishtinë, Gjiilan, Pejë, Tetovë e në Shkup, u shndërruan në qendra linçi. Nga të arrestuarit kërkonin që të bashkëpunonin për zbulimin e shokëve e kur veprimtarët e NDSH-së nuk pranonin, atëherë fillonin proceset e montuara e shumë të stërgjatura gjyqësore, ku u shqiptoheshin veprimtarëve shqiptarë dënime të

rënda nga ato me 20 vjet heqje lirie e deri te dënimi edhe me pushkatime.

Në bazë të të dhënave dokumentare dhe memoriale del se organet jugosllave të ndjekjes edhe pse si dëshmi kishin të dhëna të bollshme për veprimtarinë e NDSH-së, dhe Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare nuk arriten t'i zbulojnë e t'i burgosin të gjithë anëtarët e veprimtarët shqiptarë, por në rend të parë synim kishin kapjen e organizatorëve dhe udhëheqësit e tyre, ngase po të arrestohej një numër i madh i tyre, atëherë nuk do të reflektohej mirë nga qarqet ndërkombëtare dhe se do të kompromitohej shteti.

Pushteti e kishte sjellë në Kosovë majorin e OZN-ës, Dimitrije Kolkoviçin, i cili shquhej si ekspert hetuesie kundër shqiptarëve, pasi kishte kryer hetimet kundër veprimtarëve shqiptarë në Shkup. Ai kishte ardhur në Ferizaj për t'i udhëhequr hetimet kundër disa veprimtarëve shqiptarë të Gjilanit, Ferizajt dhe Kaçanikut. Më pastaj OZN-a kishte filluar edhe arrestimin anëtarëve të NDSH-së të Gjilanit. Në këtë aksion të OZN-së u arrestuan Rexhep Shemë Dajkoci, Maliq Sahiti, Mulla Riza Osmani, Ramadan Agushi, Destan Budrika, Jakup Salihu, Mumin Jakupi, Azem Sylejmani, Sylë Ademi, Ibrahim Karaqeva, Njazi Atallahu-Fehmiu, Arif Sylqini etj, kurse nga ky aksion kishte shpëtuar Saqip Sylejmani, i cili kishte ikur në Itali.

Sipas një shkrese zyrtare të datës 22 tetor 1946, që të gjithë janë kapur gjatë natës, ndaj të cilëve me urdhër të togerit të OZN-ës, V. Vojvodiq, filloi procedura kundër të arrestuarve duke i akuzuar për vepër penale kundër popullit dhe shtetit. Të arrestuarit nga burgu i Gjilanit në mbrëmje të 22 tetorit 1946 lidhen dy nga dy dhe dërgohen për hetime në burgun e Ferizajt. Nga grupi ishte ndarë vetëm Rexhep Dajkoci, kundër të cilit u përdor tretman i veçantë. Megjithatë, të gjithë të arrestuarit ishin dakorduar që gjatë hetuesisë se çka mund të flasin, por nga të gjithë, më i dinjitetshëm ishte dëshmuar Rexhep Shema,

i cili e sakrifikoi vetveten për t'i shpëtuar të tjerët duke mos pranuar se kishte bashkëpunuar me ndonjërin nga të arrestuarit. Kjo shihet qartë edhe në procesverbalet e hetuesisë kundër Rexhep Dajkocit, por edhe te të tjerët.

Po ashtu, në Ferizaj më 15 gusht 1946 burgosen edhe tre anëtarë të tjerë të NDSH-së, si Sefedin Shabani, Rrustem Statovci dhe Lazër Josipi. Ndërkaq, më 21 tetor 1946 pasoi aksioni i arrestimeve të 19 veprimtarëve shqiptar nga Ferizaji e Kaçaniku.

Në fakt në procesin e Gjilanit u përfshinë veprimtarët shqiptarë, të cilët edhe u dënuan, si Hamdi Berisha, Maliq Sahiti, Ramadan Agushi, Jakup Malisheva, Rexhep Shemë Dajkoci, Arif Salihu, Riza Osmani, Destan Budrika, Lazër Josipi, Rrustem Statovci, Sefedin Shabani, Hysen Dalladaku, Ismail Mema, Njazi Çarkaxhiu, Hamdi Dalipi, Zija Shuku, Haki Zylfiqari, Salih Aliu, Ilaz Ibrahimimi, Murat Zherka, Fehmi Zherka, Hajredin Fazli Duraj, Sylë Fejza, Abaz Behluli, Xhemajl Maksuti, Hajrush Halimi, Fahri Halimi, Hilmi Ejupi, Shefki Metushi, Ibtahim Grainca, Asllan Buza dhe Rifat Tasholli.

Ndërkaq pas një kohe që ishin maltretuar e mbajtur në burg, ishin liruar nga aktakuza, si Mumin Jakupi, Shaban Bekteshi, Ismajl Sylejmani, Katarina Josipi (ishte e vetmja femër), Gani Xaja dhe Ali Murseli.

Pra, në këtë proces u dënuan 32 persona, prej tyre një u dënua me vdekje, ndërsa 31 të tjerë u dënuan me gjithesej 316 vjet burg të rëndë. Ndër ata ishte edhe vëllai i Katës - Lazëri, që u dënua me 12 vjet burg.

Kalvari i jetës private të Katit

Bile në aktgjykimin e Katarina Josipit - Pjetrit, ndër të tjera shkruante: “Katarina Josipi - Pjetri, e bija e Gjinit dhe e Gjystës, e moshës 23-vjeçare, shqiptare, e besimit katolik, shtetase e RFPJ-së, amvise, e martuar, pa fëmijë, kinëse e padënuar, me

gjendje të varfër ekonomike, tani në burgun hetues...” (*Sabile Keçmezi-Basha “Anëtarja e devotshme e NDSH-së”, Koha ditore, Prishtinë, 17 shkurt 2007, faqe 44*). Megjithatë, të gjithë ata që u liruan nga aktgjykimi u cilësuan si “armiq të popullit”. Nga kjo del se pushteti i atëhershëm jugosllav nuk i qitëte në harresë. Këtë e dëshmon fakti se Katarina Josipin pas daljes nga burgu, UDB-ja kishte ndërmarrë veprime të tjera kundër saj.

Në anën tjetër, ka mbretëruar një mendim se Kati nuk ka pasur jetë private. Vërtet ajo ishte shumë e angazhuar, por pati edhe jetë private. Qe martuar me Hil Pjetrin, emigrant që konsiderohej në atë kohë, nga Kavaja e Shqipërisë. Ajo ishte bërë edhe nënë: Lindi dy fëmijë që i vdiqen nga një sëmundje e rëndë, katër dhe dy vjeç. Më vonë mbeti edhe pa burrin, të cilin pushteti jugosllav ia dëboi nga Kosova si person i padëshiruar dhe e ktheu në Shqipëri. Kati nuk u martua më kurrë. Mirëpo, një vit para se të vdiste (1968), ajo e vizitoi ish-bashkëshortin në Kavajë. Kati ia vizitoi familjen e tij të re. Ajo ia njohu gruan dhe dy fëmijët e burrit, të cilët kishin po të njëjtit emra që paten edhe fëmijët e Katit.

### Unaza e Katit

Në fund, të themi edhe atë se me emrin e Katit, në vitin 1971, është pagëzuar Konkursi për Dramë Origjinale i Teatrit Kombëtar të Prishtinës, i publikuar nga po ky Teatër, konkurs ky që deri sivjet nuk funksionoi, pastaj me emrin e saj (“Katarina Josipi”) është pagëzuar edhe Shoqëria kulturo - artistike në Zym të Hasit të Thatë, që është themeluar (më 4 maj 1970) në njëvjetorin e vdekjes së Katit, e cila sivjet shënon 37-vjetorin e themelimit dhe të punës së suksesshme. Me emrin e Katit është pagëzuar edhe çmimi për rolin më të suksesshëm të femrës aktore në komedi (në Preshevë të Kosovës Lindore), si dhe në vendlindjen e saj, në Zym të Hasit, tash e disa vjet jepet çmimi “Unaza e Katit”.

Por e kemi borxh jo vetëm ta përkujtojmë emrin e Katit por edhe ta përtrijmë emrin e saj nëpër institucione, së paku t'ia ngrisim një përmendore në vendlindje, në Ferizaj, në Prishtinë, apo në vende të tjera të Kosovës e më gjerë në trojet etnike shqiptare.

*(Kumtesë e paraqitur në Simpoziumin e të Djathtës shqiptare, të mbajtur në afërsi të Ferizajt, më 27 korrik 2008)*

**Mr. Besim MUHADRI**

### **Tradita hasjane e shkrimit të shqipes**

*“Dhe mund të flitet për një traditë ndër “hasjane”,- për shkrimin e shqipes, e pakta nga Pali gjer te Pjetër e Lukë Bogdani....” - Dhimitër S. Shuteriqi*

Siç dihet, dokumentet e para të shkrimit të gjuhës shqipe i hasim që nga shekulli XV, përkatësisht që nga Formula e pagëzimit me autor Pal Engjëllin (1462), ndonëse gjurmë apo dëshmi të shkrimit të gjuhës shqipe datojnë edhe më herët, përkatësisht nga viti 1332, te pohimi i murgut francez Brocardus Monacus (Guillelmus Adae) se “Shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë alfabetin latin në përdorim dhe në tërë librat e tyre”. Kjo thënie e këtij murgu jep për të kuptuar një të vërtetë të pakontestueshme se gjuha shqipe përveç që ishte folur në këto troje të banura me shqiptarë, ajo edhe ishte shkruar. Me këtë thënie të këtij murgu ne mund të kuptojmë se në këtë gjuhë të lashtë të Evropës mbase edhe ishin shkruar libra dhe gjatë shkujve të mbushur plot errësisrë padëshmie dhe se do të ketë pasur edhe shkrimtarë shqiptarë, të cilët u “tretën” poashtu në errësisrën e harresës dhe të mungesës së dëshmive, të cilat mund t'i ketë përbirë tymi dhe flaka e luftërave të shumta të zhvilluara në këto troje gjatë shekujve. Si pasojë e mungesës së

dëshmime dhe të së vërtetës së fatit të gjuhës shqipe dhe të lërimin të saj na vjen mjaft e errësuar edhe dëshmia shumë e sinqertë e murgut Brokardus dhe si pasojë e gjithë kësaj edhe dokumentimi ndoshta shumë i vonuar i shkrimit të librit të parë në këtë gjuhë (së paku kështu dokumentohet deri më tani) i “Mesharit” të Gjon Bdek Buzukut (1555).

Por dëshmi të vonuara, apo edhe të “errësuar”, të pasqaruara në masë të duhur na vijnë edhe në shekujt e mëvonshëm, qoftë për librat, qoftë edhe për autorët e tyre. Një gjë e tillë do të ndodhë edhe me Pal Hasin, një ndër autorët e parë të mundshëm të një libri, tashmë inekzistentë dhe të mbetur vetëm si i cituar, por kështu do të ndodhë edhe me Andrea Bogdanin e ndonjë autorë tjetër shqiptarë, emrat dhe veprat e të cilëve, për shkak të rrethanave të ndryshme historike, mbetën në margjinat e kujtesës historike.

Pal Hasi apo prijësi i traditës hasjane të shkrimit të shqipes Emri i Pal Hasit, i këtij françeskani shqiptar, i cili duhet të ketë shërbyer si meshtar në kishat e Shqipërisë veriore, përkatësisht në territoret e Kosovës së tashme, përmendet vetëm të Pjetër Budi, i cili poashtu ishte prift dhe shërbeu në fund të shekullit XVI dhe në fillim të shekullit të XVII në kishat e Shqipërisë veriore, përkatësisht të Kosovës së tashme. Budi njëherësh njihet edhe si poeti i parë shqiptar dhe autor i disa librave të përkthyer për nevojat e klerit katolik të Shqipërisë së asaj kohe. Në parathënien e librit të tij “Doktrina e krishterë” (1618), Budi ndër të tjera thotë: “Shkrova mbë gjuhu tanë ma parë do kapituj të Ditësë gjyqit, qi i gjeta shkruom Atit shumë ncë ndershmit e ncë devotshmit, frat Palit prej Hasi, të cijtë, ende me do të tjera nshtuome, disa herë tue i shkruom, kur tue pamë se ishnë për të madhe ndihmë e fruitë shpirtit t’atij populli, e aqë ma tepërë të disa priftëne, qi dëshirojinë me i pasunë, hina për gjithë ditë ka pak tue nshtuom, shkrova ende sa të tjera kafshë, sa mujta, ncë tjera gjuhush tue i nkthjem mbë gjuhu tanë; e ndë e vonë,

mbasi andej u dashë, erdhshë mbë Romë (...) Tue pamë se gjuha jonë asndonjë letërë e të mpsuom s'e ka, me të cijtë të mundëjë ndë ta me u ndihmuom feja e Krishtit, zuna fill, mund aqë sa munda, nktheva këtë shinte Doktrinë gjuhë çë lëtime mbë gjuhë t'arbëreshë(...)"

Siç shihet, ky është Pal Hasi, apo fort i nderuari frat Pali prej Hasi, të cilin e citon Pjetër Budi në vitin 1618, përkatësisht në parathënien e librit "Doktrinë e krishterë". Është i pari dhe i vetmi citim që i bëhet nga një autor, sepse më nuk do të hasim asnjë të vetmen gjurmë të ekzistimit të këtij personaliteti fetar dhe letrar të shekullit XVI. Megjithatë, qoftë edhe përmendja e emrit të Pal Hasit nga ana e Pjetër Budit është një dëshmi e mirë dhe argumentuese për ekzistimin e një personaliteti të nderuar siç ishte Pali prej Hasit, i cili duhet të ketë shërbyer si frat në gjysmën e dytë të shekullit XVI në kishat e Shqipërisë Veriore, në Kosovën e tashme, apo edhe gjetiu dhe madje të ketë shkruar apo përkthyer libra për nevojat e kishës shqiptare dhe priftërinjëv shqiptarë që shërbenin në ato kisha, në një kohë kur inkuzicioni bënte kërdi, në një anë, ndërsa Perandoria Otomane, në anën tjetër.

Autor libri apo figurë e dorëshkrimeve shqipe të tretura Sipas dëshmimeve që na i jep Budi në "Të rekomanduomit", përkatësisht në parathënien e "Doktrinës...", Pal Hasi, apo Pali prej Hasi, siç i thotë ai, ishte autor i një libri të quajtur "Dita e gjyqit", që doemos është një përkthim i shërbesave fetare nga gjuha latine në shqip. Poashtu, sipas dëshmimeve të Budit, ai libër, ndonëse shumë i rëndësishëm, kishte dhe shumë të meta, të cilat e shtyejnë atë që të ndërhyjë gjuhësisht e ndoshta edhe në aspekte të tjera, në mënyrë që të krijonte një libër krejtësisht tjetër, apo një kopje apo variant të zgjeruar të "Ditës së gjyqit" të shkruar apo të përkthyer nga Pali prej Hasit. "Shkrova mbë gjuhu tanë ma parë do kapituj të Ditësë gjyqit, qi i gjeta shkruom Atit shumë ncë ndershmit e ncë devotshmit, frat Palit

prej Hasi, të cijtë, ende me do të tjera nshtuome...”. Këto fjalë të Budit të japin për të kuptuar se “Doktrina e krishterë” është e shkruar mbi bazën e “Ditës së gjyqit” të Pal Hasit, apo më mirë të themi mbi bazën e disa kapitujve të këtij libri të Palit, tashmë inekzistentë, por gjithësesi të cituar.

Në gjuhën e studimeve letrare kësaj i thonë hipertekst, apo tekst mbi tekst. Kjo do të thotë, dhe këtë e pranon edhe vetë Budi, se “Doktrina e krishterë” është një libër i ndërtuar mbi hipertekstin e një libri tjetër, për të cilin ai na njofton vetë. Ne nuk e dijmë saktësisht nëse ky libër i Budit është tërësisht i tij, apo vetëm një redaktim apo përpunim i një libri të mbetur në dorëshkrim nga Pal Hasi, i cili gjithashtu librin e tij, apo “kapitujt” e librit të tij, që i përmend Budi i kishte shkruar apo përkthyer poashtu si një nevojë imediate për klerikët shqiptarë dhe për komunitetin shqiptar që falej dhe lutej në kishat anekënd Shqipërisë së asaj kohe, ku të gjitha shërbesat fetare beheshin në gjuhën latine, italiane dhe greke. Kjo, sikurse edhe Budin, e kishte shtyrë para tij edhe Pal Hasin që të hartonte një libër e ndoshta edhe më shumë, por të cilët ai ose nuk pati mundësi ta botonte apo t’i botonte, për shkak të rrethanave kohore dhe historike, të Inkuzicionit apo edhe për shkak të moslejimit nga ana e Vatikanit që të botoheshin libra në gjuhën shqipe, apo edhe për arsye financiare apo dhe të vdekjes së hershme të tij. Ne nuk e dijmë nëse Pal Hasi vdiq i ri apo në moshë të shtyrë, ashtu sikurse që nuk e dijmë as për vitin e lindjes dhe të vdekjes së tij.

Siç dihet Budi e nisi veprimtarinë e tij me libra në gjuhën shqipe kur gjeti shkrimet e Pal Hasit, përkatësisht duke marrë e duke i përpunuar disa kapituj të “Ditës së gjyqit”, mirëpo ne nuk dijmë nëse këta kapitujt të këtij libri që ai citon, të shkruar apo të përkthyer nga Pal Hasi ishin dorëshkrim, apo libër nga i cili mori apo u shërbye Budi, duke e përpunuar tekstin dhe duke e botuar atë si libër i veçantë, në të cilin botoi qindra vargje duke u bërë vetë poeti i parë shqiptarë (hiq tetë vargje të

“Këngës së përshpirtshme” të Lekë Matrangës, 1592). Këtë askush s’e thotë, sepse nuk kemi informacione të tjera. Megjithatë ne mund të themi një gjë që është fort e sigurtë se tërë “Doktrina e krishterë” e Pjetër Budit është e ndërtuar nga brumi i gatshëm i gatuar nga Pal Hasi. Budi bëhet i sinqertë kur thotë se mori nga Pali i Hasit tekstin e të cilit e përmirësoi, e përpunoi, e plotësoi dhe së fundi e botoi duke e hedhur firmën e tij si autor. Në këtë rast, nëse për hartimin e librit të tij, të cilit e botoi më 1618 ka marrë nga kapitujt e “Ditës së gjyqit” të Pal Hasit, Budi është dashur që së paku në kopertinat e këtij libri (“Doktrina e krishterë”) të shkruante edhe emrin e “ncë ndershmit e ncë devotshmit, frat Palit prej Hasi”, në mënyrë që ai në këtë rast të ishte bashkautor. Por këtë s’e bëri dot, ndërsa Pal Hasin e la vetëm si autor të cituar, pas të cilit emër do të mbeten shumë dilema, shumë paqartësi, shumë mjegull, qoftë për kohën e të jetuarit, qoftë edhe për të shkruarit dhe të të lënit trashëgim diçka për letërsinë, kulturën dhe gjuhën tonë deri atëherë shumë pak të lëruar. Nga që emri i Pal Hasit figuron vetëm në parathënien e librit të Budit, por jo edhe në kopertinë si bashkautor, apo autor i veçantë, atëherë ai mbeti vetëm si autor i cituar, ndonëse në këtë rast të gjitha rrugët të shpiejnë te konstatimi se ai është një autor origjinal (vetëm te “Doktrina e krishterë”), ndërsa Budi si një “përpunues i teksteve të Palit prej Hasi”. Se Budi ishte një përpunues dhe bashkautor me Palin, këtë e pohon edhe Selman Riza, i cili punën e këtij shkrimtari, kleriku dhe përkthyesi librash fetarë e sheh jo vetëm si një kopjim të thjeshtë, por ripërkitje stilistike apo ripërpunim redaksional. Megjithatë, duke pasur parasysh tretjen e këtij krijuesi, apo mbetejen e tij nën “hijen” e cituesit, i cili edhe mund të ketë marrë nga vepra e tij, sipas Sabri Hamitit, Pal Hasi mbetet vetëm figurë e letërsisë së shkruar e të tretur, që jeton si farë në kujtesën popullore. ”Për ne Pal Hasi mbetet një figurë e dorëshkrimeve shqipe të tretura”, thotë studiuesi Hamiti.

A ishte Pal Hasi bashkëkohës i Gjon Buzukut?

Por, ashtu sikurse dilema rreth autorësisë, ekziston edhe dilema e të jetuarit, e gjuhës dhe e alfabetit më të cilat Pal Hasi i shkroi apo i përktheu librat e tij. Kur jemi te koha e të jetuarit, duke u bazuar në të dhënat që jep Budi në parathënien e librit të tij, Shuteriqi dhe studiues të tjerë të letërsisë shqipe, hamendësojnë se Pal Hasi duhet të ketë vdekur në fund të shekullit XVI, që do të thotë dikund rreth viteve 1590-1599, kohë kjo kur edhe Budi filloi shërbimin e tij kishëtar në ato vende ku me siguri do të ketë shërbyer Pal Hasi, gjurmët e të cilit i gjeti ai. Por nëse kemi një pohim për periudhën e vdekjes, ne nuk kemi datën e lindjes së këtij autori. “Pali ka qenë përshtatës apo përkthyes i një vepre me titull “Dita e gjyqit” dhe se ka jetuar në pjesën e dytë të shekullit XVI”, pohon Dhimitër S. Shuteriqi. Ndërkaq duke folur për gjuhën e autorit dhe alfabetin me të cilin ai mund të ketë shkruar, Shuteriqi mendon se ai duhet të ketë shkruar me alfabetin tonë të vjetër latin të Veriut, të njohur që nga Buzuku, konstatim që qëndron. Po ky studiues Pal Hasin e vendos midis Buzukut dhe Budit: “Ai duket se bën kapërcimin midis dy autorëve shqiptarë, Buzuku dhe Budi, me emrin e të cilëve janë të lidhura fillimet e një përpjekjeje të re për shkrimin e shqipes, mbas rrëtimeve që pësoi kultura jonë e shkruar gjatë luftërave të shekujve XIV-XV kundër osmanëve. Kuptohet, pra interesi i veçantë që ngjall emri gati i panjohur i Pal Hasit”.

Me këtë nënkuptohet se Pal Hasi, si një autor i panjohur, por gjithësesi interesant, mund të jetë edhe bashkëkohës i Gjon Buzukut, ndërsa vepra apo veprat e tij, tashmë të humbura dhe të panjohura për historinë e letërsisë shqiptare, mund të jenë shkruar edhe para, njëkohësisht dhe pas “Mesharit”, ndërkaq “kapitujt” e “Ditës së gjyqit” të përmbledhur në ndonjë libër të kryer apo të pakryer mund të jenë të asaj kohe, por ndoshta në pamundësi botimi ato mund të kenë mbetur në sirtarët apo

tavolinat e qelave kishëtare ku shërbeu Pali, qoftë në Hasin e tij, si vend i lindjes, në Kosovën e tashme, apo edhe në vende të tjera të Shqipërisë ku mund të ketë shërbyer. Puna dhe veprimtaria e këtij autori, bashkë me emrin, po të mos e kishte cituar Budi, mund të ishte zhdukur tërësisht. Askush tjetër nuk e përmendi deri në atë kohë e as më vonë, përveç Budit. Madje as Pjetër Bogdani, një shkrimtar tjetër i rëndësishëm i letërsisë së vjetër shqipe, i cili poashtu vinte nga e njëjta krahinë nga e cila ishte Pal Hasi. Dhe kjo mospërmendje vazhdon edhe më pas.

Pjetër Budi u mbyt në valët e trazuara të Drinit në prag të krishtlindjeve të vitit 1623, pra në fund të dhjetorit të vitit 1622, duke lënë pas vetes një opus bukur të konsideruar veprash fetare e letrare me mjaft interes për gjuhën dhe letërsinë shqipe. Por nëse ai vdiq, apo u mbyt, dhe nëse pas vete la veprat, të cilat do të pasoheshin edhe nga shumë të tjera po të mos vinte ajo vdekje e papritur, ai me vete s'e mori edhe dëshminë e të ekzistuarit të një Pal Hasi, të cilin e njëjtte mirë dhe e respektonte dhe nga i cili u shërbye kur shkroi "Doktrinën e krishterë" apo edhe ndonjë libër tjetër. Pas vete, përveç veprave, Budi la dëshminë shumë të fuqishme të ekzistimit të një emri që mund të simbolizojë dhe të dëshmojë edhe ekzistimin e një tradite shumë më të hershme të shkrimit të shqipes, por edhe të ekzistimit të ndonjë shkolle, nga e cila dolën personalitete të larta fetare, kombëtare e kulturore, siç janë Andrea, Pjetër, Lukë Bogdani, por edhe ndonjë tjetër, që të gjithë nga treva e Hasit. Pse e them të një shkolle? Sepse kjo ende s'është dëshmuar, prandaj do një elaborim më të thuktë dhe kredhje në histori. Ne në shekullin XVI nuk njohim ekzistimin apo funksionimin e shollave në krahinën e Hasit, në të cilat mund të jenë shkolluar dhe edukuar gjenerata të tëra, nga gjiri i të cilave dolën personalitete kaq të nderuara që përjetësisht mbetën në piedestalin e historisë, kulturës dhe të humanizmit shqiptar, siç janë emrat e lartcekur, megjithatë ne

duhet të shprehim kaqardhje që nuk mund të bazohemi dikund për të nxjerrë ndonjë konkludim apo dëshmi të funksionimit të një shkolle të tillë. Megjithatë, duke u bazuar në veprimin e gjithë këtyre personaliteteve, ne duhet të “dyshojmë” vërtet në ekzistimin e ndonjë shkolle në Has, nga e cila merrnin mësimet e para, sepse përndryshe nuk do të ishte e mundur dalja në skenë e këtyre penave kaq të fuqishme, të cilat pastaj kryen shkolla të larta nëpër kolegje dhe akademi më të njohura të kohës. Përndryshe, pa posedimin e një tradite më të hershme shkollimi, emancipimi etj., vështirë se do të vinte deri të orientimi dhe vendimi për të marrë në “sy” botën në zënien e dijeve, nga e cila pas disa vitesh do të ktheheshin me grada shkencore.

Pal Hasi dhe Andrea Bogdani – autorë të cituar të një letërsie të tretur

Tradita hasjane e shkrimit të shqipes nuk kishte të rreshtur. E filluar nga Pali prej Hasit, gjurmët e ekzistencës së të cilit i shpërfaqti vetë Pjetër Budi në parathënien e “Doktrinës...”, dëshminë e vazhdimit të kësaj tradite na e forcon pohimi i Pjetër Bogdanit për një Gramatike latinisht-shqip të të ungjit, Andrea Bogdani, e cila për fat të keq, para se të vinte në duart e lexuesve u zhduk pa gjurmë.

Për Andrea Bogdanin dijmë se ishte një klerik i përmendur i shekullit XVII dhe i ungji i Pjetër Bogdanit, arqipeshkv i Shkupit, post të cilin pas vdekjes së Andreas do ta trashëgojë nipi i tij Pjetri. Por nëse Andrea ishte një personalitet shumë i nderuar dhe i përgatitur i kohës së tij, në shërbim të kishës dhe atdheut, i cili mund të ketë ndikuar në përgatitjen e Pjetrit dhe të pasardhësve të tjerë, ne nuk kemi ndonjë dokument që do të na dëshmonte sheshazi se ai ishte edhe një personalitet kaq i nderuar i kulturës dhe i gjuhësisë. Dëshminë se ai ishte një njeri i përkushtuar i lërimit të gjuhës shqipe, por edhe i njohjes së gjuhëve të tjera, na e ofron Pjetër Bogdani në parathënien e

“Cuneuesit...”, ku thotë se i ungji i tij kishte shkruar “një gramatikë fort të godiçime latine-shqip”. Vepra në fjalë, e cila ishte gati për botim, nuk ishte botuar deri në atë kohë, mbase për shkak të moslejimit nga ana e propagandës Fide, të Vatikanit apo edhe për ndonjë arsye tjetër. Këto pengesa dhe vështirësi i kishte pasur edhe vetë Pjetri për librin e tij “Çeta e profetëve”, të cilin, siç dihet arriti ta botojë vetëm pas dhjetë vjetësh të pritjes, do të thotë pasi që iu desh ta përkthente edhe në gjuhën italiane. Sipas Pjetër Bogdanit, gramatika latinisht e shqip e Andrea Bogdanit, të cilën pas vdekjes së të ungjit e mbante Pjetri, i humbi rreth vitit 1684, kur edhe vdiq Andrea. Ky vit shënon edhe kohën e luftës austro-turke. Në bazë të informacioneve që na vijnë nga analet e kohës, por edhe nga biografët e tij, Pjetër Bogdani, për shkak të veprimatrisë së tij patriotike dhe të tentimit të organizimit të shqiptarëve në luftë kundër turqëve, shpesh ishte i detyruar që të fshihej shpellave dhe maleve nga pushtuesit otomanë. “Duket se gramatika qe shkruar për nevojat e mësimi të latinishtes prej klerit katolik shqiptar. Pjetri thotë se i ungji e dinte mirë shqipen dhe pati ndihmuar e nxitur për të shkruar veprën e tij “Cuneus...”.

Andrea Bogdani, shikuar nga ky prizëm, përpos që ka mbetur një personalitet shumë i nderuar i kohës, na del edhe një autor tekstesh të rëndësishme, siç ishte hartimi i një gramatike. Ai ishte njohës i mirë i shqipes dhe i latinishtes, prandaj, duke qenë një gjuhëtar i mirëfilltë, kishte arritur të shkruante një gramatikë shumë të qëlluar, apo siç shprehet poliglotti dhe prozatori i parë i shqipes, Pjetër Bogdani, “fort të godiçime”. Gramatika në fjalë, për shkak të rrethanave tragjike që e përcollën kombin shqiptar, e bashkë më të edhe kulturën, gjuhën dhe intelektualët shqiptarë, humbi, apo siç pohon P. Bogdani “u tret si kripa në ujë”, që do të thotë u zhduk. Kjo gramatikë, humbja e së cilës doemos se paraqet një humbje të pakompensueshme për gjuhësinë dhe për kulturën e gjithëmbarshme shqiptare, me siguri do të jetë tretur dikund

maleve dhe shpellave kah u strehua dhe u fsheh Pjetër Bogdani në kohën e ekspeditave turke në pjesën e dytë të shekullit XVII. Atë mund ta ketë mbuluar pluhuri i kohërave, apo flakët e luftërave, por dëshmia e Bogdanit se i ungji i tij kishte shkruar një gramatikë fort të goditur, është për t'u besuar. Librin në fjalë nuk e kemi, ashtu sikurse nuk e kemi as librin "Dita e gjyqit" të Pal Hasit, por për to janë dëshmitë. Përderisa për të parin flet një i afërm i tij, pra i nipi, që u dëshmuar dhe ka mbetur një nga figurat më universale të kohës së tij, për të dytin, pra për Pal Hasin flet një personalitet tjetër, poashtu i rëndësishëm i kohës, Pjetër Budi, një autor i cili letërsisë dhe gjuhës shqipe i la një dëshmi fundamentale dhe një visar shumë të çmuar. Dhe nëse Pal Hasi, sipas dëshmimeve të Pjetër Budit është një autor që kishte përkthyer apo përshtatur pjesë nga libri i shenjtë, tjetri, pra Andrea Bogdani është hartues i një gramatike dygjuhëshe. Ata kishin të njejtin qëllim: Të shkruanin apo të përkthenin tekste për nevojat e kishës dhe të klerikëve katolikë shqiptarë, të cilët kishin vështirësi në kuptimin e latinishtes, apo të italishtes, në të cilat gjuhë edhe predikoheshin ritet fetare në kishat shqiptare. Tendenca për hartimin e librave të veçantë, për nevojat e klerit katolik shqiptar, ishte një tendencë e një rëndësie të madhe, e cila shoqërohej me rreziqe të mëdha, madje edhe me jetë, siç i kushtoi Budit, por mbase edhe Pal Hasit dhe ndonjë autori tjetër.

Dhe ndonëse Pal Hasin dhe Andrea Bogdanin i përcolli një fat i keq i përbashkët: ai i mosnjohjes së veprave të tyre, që do të thotë i mosnjohjes së fryteve të punës së tyre shumëvjeçare, ata i përcolli edhe një fat tjetër i përbashkët: mbetja vetëm si autorë të cituar, apo siç e thotë Sabri Hamiti, autorë të një letësie të tretur. Megjithatë, veprat e Palit dhe të Andreas, edhe kështu, sikur arrijnë të përçojnë tërë kompleksitetin e veçantisë dhe të rëndësisë së tyre kombëtare.

Pjetër Bogdani - autori i parë shqiptar në vështrimin modern të krijuesit

“Dhe mund të flitet për një traditë ndër hasjane, që të mos themi domosdo “traditë hasjane” për shkrimin e shqipes, e pakta nga Pali gjer te Pjetër e Lukë Bogdani” janë rreth katër breza. Me këtë traditë, duke filluar prej Andreas, Bogdanët i lidhi Budi apo ishin të lidhur brendapërbrenda tyre, duke nisur nga Pal Hasi”. Kështu shprehet Dhimitër S. Shuteriqi në një shkrim të tij për Pal Hasin, rrënjët e të cilit i gjen në Has. Tadiën hasjane të shkrimit të shqies, apo traditën ndër hasjane të shkrimit, siç shprehet ai, e quan një traditë të kultivuar me mjaft pasion dhe përgjegjësi. E filluar nga Pali e ndoshta edhe më herët, kjo traditë u pasua edhe nga Bogdanët e Hasit, në krye me Andrean dhe e vazhduar nga Pjetri e Lukë Bogdani.

Dhe përderisa Andrea nuk njihet si autor për shkak të tretjes së librit të tij si “kripa në ujë”, siç thotë Pjetër Bogdani, ashtu sikurse edhe Pal Hasi, që konsiderohet si nismëtar i “traditës hasjane të shkrimit të shqipes”, i cili citohet nga Budi, por veprën e tij s’e njohim, autori i tretë, vazhdues i kësaj tradite, është Pjetër Bogdani. Ai në letërsinë tonë vjen si një autor i dëshmuar dhe mjaft origjinal. Vepra e tij e shkruar në vitin 1675 dhe e botuar dhjetë vite më vonë, 1685, “Kuneus prophetarum” (Çeta e profetëve) padyshim se ka mbetur një nga veprat monumentale të kulturës sonë të gjithëmbarshme, duke e renditur autorin në korife të letërsisë. “Bogdani me “Çetën e profetëve” shfaqet krijues. Pra ai është autori i parë shqiptarë në vështrimin modern të krijuesit individual. Vepra e tij filobiblike ka strukturën e doktrinës, pra librit të ndërtuar nga ligjëratat për oratori, filozofi e politikë”.

Mendimi i shfaqur i Hamitit në lidhje me profilin krijues të Pjetër Bogdanit, është dëshmi që flet për një krijues të gjithanshëm. Për një njeri të përgatitur si në aspektin e oratorisë, filozofisë, letërsisë dhe të teologjisë, cili cilësohet si “shkrimtari i parë i Kosovës së tashme”, “korife i gjuhës

shqipe”, “krijues i parë origjinal shqiptar”, autori i parë i prozës shqipe” etj. “Vepra e Bogdanit jep materje shpirtërore, mendore e poetike me rëndësi të parë edhe për poetin, edhe për studiuesin”.

Duke folur për origjinalitetin dhe gjenialitetin poetik dhe krijues të Bogdanit, i cili tejkalon idenë fetare dhe futet në rrafshin kombëtar, I. Rugova në studimin e tij për veprën e Bogdanit, ndër të tjera shprehet: “Gjeta, se pas çëshjteve të tjera filozofike - teologjike e filozofiko-shkencore, fliste edhe për metaforat, për tropologjinë dhe për figurat e ndryshme të retorikës si dhe për disa aspekte të poetikës”. Duke folur më tutje për rëndësinë e veprës së Bogdanit, por edhe të përpjekjeve të autorëve shqiptarë, veçanërisht të atyre që konsiderohen si pjesë e traditës hasjane të shkrimit, Rugova mendon se ajo është një “sintezë e këtyre përpjekjeve, një kurorëzim i denjë dhe gurthemeli për veprat e ardhshme”. Kur jemi te tradita letrare hasjane, e vlerësuar si e tillë për herë të parë nga Dhimitër Shuteriqi, edhe Rugova pranon se me të vërtetë mund të bëhet fjalë për një traditë të tillë. Ky studiues në këtë traditë përveç Pal Hasit, Pjetër Mazrrekut, Andrea, Pjetër e Lukë Bogdani e sistemon edhe Pjetër Budin, jo si ndërlydhës, siç konsideron Shuteriqi, por si autor të drejtpërdrejtë të saj. Futjen e Budit brenda kësaj tradite ai e bën me arsyen jo se ai ishte nga krahina e Hasit, siç ishin pesë të cituarit tjerë, por për shkak të asaj se ai (Budi) një pjesë të madhe të aktivitetit të vet e kishte zhvilluar në territoret e Kosovës së tashme, që do të thotë se nga kontakti i vazhdueshëm me traditën tashmë të krijuar ndërhasjane ai kishte sajuar edhe veprat e veta. Duke cilësuar lart rolin dhe kontributin e autorëve të traditës letrare hasjane Rugovën nuk e habit fakti i daljes në dritë i një vepreje siç ishte “Çeta e profetëve” e Pjetër Bogdanit, e cilësuar si vepra e parë origjinale në gjuhën shqipe.

Pjetër Bogdani ishte njohës i thellë i gjuhës, traditës, i historisë së atdheut të vet, por edhe i teologjisë, retorikës, i teorisë së letërsisë, i poetikës dhe i fushave të tjera të kulturës dhe të shkencës së kohës. Kjo bënte që ai të ishte një intelektual i mirëfilltë dhe një njeri me kulturë të gjerë dhe që e arsyetonte plotësisht gradën shkencore të doktorit të teologjisë të cilën e mbante. Veçoritë e këtij krijuesi si një intelektual i mirëfilltë i kohës, e bënte edhe njohja e shtatë gjuhëve të vjetra, si i hebraishtes, arabishtes, greqishtes, armenishtes, italishtes, latinishtes dhe i siriakishtes, përmes të cilave ai kishte mundësi të konsultonte literaturë të duhur në kompletimin e dijeve të tij, të njëjtte më mirë problemet shkencore, filozofike e teologjike dhe të merrte fizionominë e një intelektualit të vërtetë të kohës kur jetoi dhe veproi, madje shpesh edhe duke i tejkaluar mundësitë e asaj kohe.

Pjetër Bogdani dhe vendlindja

Pjetër Bogdani ishte i lidhur fort me vendlindjen e tij. Siç dihet ai u lind në një fshat të krahinës së Hasit, i cili për fat të keq në kohën tonë si toponim nuk ekziston. Ai thotë se u lind në fshatin Gur, gjë që në këtë kohë e bën të pamundur përcaktimin e saktë të këtij toponimi. Por në këtë shkrim s'e kemi ndërmend të merremi me këtë çështje, sado e rëndësishme që të jetë ajo, sepse kjo mbase nuk ka ndonjë peshë të madhe, sepse autori në fjalë e dëshmon katërcipërisht se është hasjan. Në librin e tij ai fut toponime nga Hasi, ndërsa një vend të veçantë aty zë mali i Pashtrikut, mal ky që bie mospërmes krahinës së Hasit. Te Bogdani ai ka kuptimin e një mali të shenjtë, aty ku rriten, jetojnë dhe veprojnë zanat. Rëndësia dhe të qenit mitik ky mal vazhdon edhe sot. Si duket Bogdani këtu merr frymëzimin, krenarinë dhe forcën krijuese. Këtë e beson populli i Hasit, i cili me gjelozi edhe sot e ruan dhe e kultivon traditën e të besuarit në mitikën e këtij mali, por këtë e ruajnë dhe e trajtojnë në veprat e tyre edhe autorë të tjerë hasjanë të

kohës më të re. Kjo të jep për të kuptuar se ndërlihdshmëria e traditës hasjane të shkrimit është ruajtur edhe pas shumë shekujsh.

Vendlindja në veprën e Bogdanit shpërfaqet edhe si shprehje e origjinalitetit të këtij autori. Përmes kësaj ndërlihdje ai futet drejtpërdrejtë në rrafshin kombëtar. Por ndërlihdja e këtij autori me vendlindjen nuk bëhet vetëm duke futur në veprën e tij toponime nga zona e Hasit. Në veprën e tij ai tenton dhe ia arrin të inkuadrojë shumë fjalë të vjetra, apo “fjalë plaka”, të cilat janë pjesë e leksikut popullor dhe të pasur hasjan. Ngritja e fjalëve lokale ose krahinore në nivelin e përdorimit të përgjithshëm, janë një kontribut i këtij autori në pasurimin e gjuhës shqipe, por edhe të ruajtjes së këtyre fjalëve, që ndoshta ishin harruar apo po harroheshin gradualisht. Me këtë nënkuptohet se Pjetër Bogdani paraqet shqetësimin e tij për gjuhën shqipe dhe zhdukjen graduale të fjalëve të saj që dilnin nga gjiri i popullit. Kjo mund të jetë edhe një dëshmi e rëndësishme se përpos atyre veprave që i njohim, ishin apo mund të ishin shkruar edhe vepra të tjera para Bogdanit, të cilat ne nuk i njohim dhe në të cilat siç vëren ky autor nuk përfshiheshin shumë fjalë të rëndësishme të trungut të shqipes. Prandaj me futjen e këtyre “fjalëve plaka” ai “iu tregoi bashkëkohësve dhe pasardhësve një model të shkrimit të gjuhës shqipe, duke u hapur atyre rrugët më të përshtatshme të shkrimit dhe të pasurimit të saj”.

Lukë Bogdani autor i këngës së kushtimit

Lukë Bogdani është autori i katërt i “kolanës” së pagëzuar “tradita letrare hasjane”, apo tradita hasjane e shkrimit të shqipes. I lindur dhe i rritur në gjirin e shkollës së Bogdanajve të Hasit, Lukë Bogdani në letërsinë shqipe vjen si autor i një poezie kushtesë për kushuririn e tij, Pjetër Bogdanin, me rastin e botimit të librit “Çeta e profetëve” në Padovë më 1685. Me krijimin e tij njëzetvargësh, me një tetërrokësh të alternuar,

Lukë Bogdani në letërsinë shqipe hyn si një autor i një poezie kushtesë, por që dëshmon se ai ishte një krijues mjaft i talentuar, i cili përveç këtij krijimi mund të ketë pasur edhe krijime të tjera, të cilat ose nuk i ka publikuar, apo mund të kenë pasur fatin e krijimeve të paraardhësve të trungut të tij hasjan, siç ishin Pali, kushuriri Andrea dhe ndonjë tjetër.

Në krijimin e tij, që siç tham ia kushton kushuririt, Lukë Bogdani fillon me vendlindjen, por në shumë raste ai flet edhe për personalitetin e Pjetrit, për karakterin e tij si bari kujdestar religjioz gjatë kohës së shërbimit të tij, por edhe si një personalitet me kulturë e dije të gjerë dhe universale. Edhe në krijimin e Lukës, mbizotëron toponimia hasjane dhe me theks të veçantë mali mitologjik i Pashtrikut, me tërë kompleksitetin e një mali të ekzistimit të figurave dhe besimeve mitologjike, për të cilin shkruan edhe vetë Pjetri, të cilit edhe i kushtohet ky krijim, apo kjo këngë.

Dul n'GURIT bukuria.

ZANA si një sut' e naltë,

Qi s'kish mbrenda VENEQIA,

Te PESHTRIKUT muer Maltë

GURI, ZANA, VENEQIA dhe PESHTRIKU, në poezinë e Lukë Bogdanit janë të shkruara jorastësisht me shkronja të mëdha. Shkrimi i tyre në këtë formë, mendoj se shpërfaq respektin e pakontestueshëm të autorit ndaj këtyre emrave: Guri, si vendlindje e tij dhe e kushuririt si dhe e Bogdanajve të përgjithësi, Zana, si një krijesë mitologjike, besimi në të cilën ishte shumë i përhapur te hasjanët, e cila sipas tyre fshihej dikund në Pashtrik, Venecia (Venediku) si një qendër e rëndësishme kulturore, fetare, por edhe politike të asaj kohe si dhe Peshtriku (Pashtriku apo Pushtriku siç theksohet nga hasjanët), si mal i shenjtë për të cilin thureshin shumë legjenda, e që kishin krijuar respektin ndërhasjanë, madje duke e pagëzuar atë edhe si Baba (Baba Pushtriku) dhe betimi i përhershëm në të (pasha vorrin e Pushtriku), respekt dhe epitete

të cilin e gëzon edhe sot. Katër vargjet e poezisë, të shoqëruara secila me nga një emër: Guri-Zana-Veneqia-Peshtriku, të shëmbëlleshë si një formulë e rëndësishme e zberthimit të veprës dhe të personalitetit të Pjetër Bogdanit, të cilit edhe i kushtohet. Janë vargje admirimi, cilësimi dhe përçimi.

Poezia e Lukë Bogdanit është vlerësuar dhe si e tillë është konsideruar si një trashëgimi e rëndësishme letrare e shekullit XVII. “Vjersha e Lukës, sikurse edhe ajo e Lekë Sumës dhe disa vjersha të Pjetër Bogdanit, janë shenja të një veprimtarie pak a shumë të gjerë poetike në Shqipëri në shekullin XVII, pas Budit”, pohon Dhimitër Shuteriqi në librin e tij “Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850”. Ndërkaq sipas Sabri Hamitit, kjo “vepër e ndërliqshme”, siç e cilëson ai, është më afër vjershave të Budit se sa të Pjetër Bogdanit. Sipas këtij studiuesi, “kjo poezi nuk krijon njerinë në nivelin figurativ, po në strukturimin e motiveve dhe me lidhjen e tyre merr karakterin e një përmbledhjeje poetike ku dalin problemet kryesore reale dhe ideale të botës shqiptare të kohës”. Hamiti, duke e vështuar nga aspekti i ideve, poezinë e Lukës e cilëson edhe si një këngë atdhetare të thurur nëpërmjet shtresimeve historike, aktuale dhe të së ardhmes. Duke qenë një krijim në të cilin shpërfaqen ide dhe kërkesa të fuqishme atdhetare, ajo njëherësh është edhe një nga krijimet e para të këtij lloji në poezinë shqipe. Do të thotë një unikat.

Kjo do të thotë se Lukë Bogdani, duke qenë një përfaqësues i shkollës së Bogdanajve dhe i “traditës hasjane të shkrimit”, padyshim se ishte, dhe mbeti një autor mjaft serioz dhe i vlerësuar, sado që vepra e tij e arritur në këtë formë, cilësi dhe sasi është e mangët për të na ofruar mundësinë e ndonjë konstatimi përfundimtar. Mirëpo, megjithatë, jo vetëm pse njihet si autor i një libri tashmë të vlerësuar lart, Pjetër Bogdani është autori më i rëndësishëm i kësaj tradite. Përveç kësaj ai është edhe autori më i rëndësishëm i letërsisë shqipe të shekullit XVII, përkatësisht ai asaj letërsie të cilësuar si letërsi

filobiblike, e lëruar kryesisht nga klerikët shqiptarë të shekujve XVI-XVII.

## **Të tjerët për zymjanët**

**Dr. Asqeri LLANAJ (Vlorë)**

### **Në Has të Thatë, me vëllezërit e një gjaku**

*Zym, 13 tetor 2007* - Miqësinë me hasjanët e kam lidhur që në kohën e gjenocidit të fundit kundër tyre, në kohën kur Milosheviçi, edhe pse mbi gjysmë shekulli më vonë, po e barazonte vetveten me Hitlerin, madje po përpiquej t'ia kalonte atij. Ishte viti 1999, kur në Vlorë erdhën banorët e fshatit Shëngjergj. Më ra fati që në shtëpinë time të strehoj çiftin Ismet e Ganimete: përkatësisht 25 dhe 23 vjeç, së bashku me të dy fëmijët e tyre, Nolin 5 vjeç dhe Lindin 3 vjeç. Një çift i mrekullueshëm dhe me fëmijë të bukur, që mbanin në shpirt dhimbjen e lënies së shtëpisë së tyre, në momentin kur prisnin ngushëllime për humbjen e djalit të tyre të vogël prej gjashtë muajsh, paramilitarët serbë i nxorën prej saj. Rruga e tyre ishte e mbushur me lotë e dhembje. Në shtëpinë time erdhën menjëherë fqinjët, ata donin t'i takonin, të merrnin vesh si ishin, t'u ngrinin moralin. Por çifti vajtonte humbjen e shumë gjërave njëkohësisht, nuk u shkonte ndërmend as të hanin dhe, tavolina ngrihej ashtu si shtrohej. Bashkë me gruan time Liljanën, u thamë: se për moshën që kemi, ne tashmë, u konsiderojmë djalin dhe nusen e kësaj shtëpie, prandaj rrini si në shtëpinë tuaj. Të nesërmen takuam babanë e Ismetit, Halitin, ky, një burrë me një shtat mesatar, me flokë të thinjura, me sy të zinj, me një pamje të njeriut të çiltër e babaxhan. Ramë dakord që i biri tashmë do të kishte dy palë prindër. "Biologjikët jeni ju, ndërsa unë jam adoptuesi" -i thashë dhe qeshëm me shaka. U bëmë miq menjëherë, vizitova vendbanimin e tij në Vlorë.

Jetonte me fëmijët e vëllait dhe të moshuarin Hasan Tanushaj. U njoha me shumë shëngjergjas, si me Ymer Cakën, të cilit fashistët serbë i kishin vranë djalin, me Agron Cakaj dhe djalin e tij, me Shaqir Cakaj, të cilin i kishin vranë djalin ushtarët serbë, me Masar Cakaj dhe dy fëmijët e tij, me Jemin Caka, me Gani Cakaj, Shefqet Tanushaj, me Muhamet, Riz e Latif Mallakaj e shumë të tjerë. Ata më treguan historinë se si kriminelët serbë vranë Ali Rahman Tanushin dhe Ibrahim Islam Mallakaj. Haliti ishte mësues dhe me tha se "unë me shokët e mi në vitin 1975, kemi ardhur në trungun amë për shkëmbim eksperience. Ishim në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Sarandë e Gjirokastrë. Erdhëm tek vëllezërit tanë të Shqipërisë mëmë, kurse tani këtë vizitë na e imponoi Milosheviçi si kasap që është duke dëbuar afërsisht një milion banorë, gjysma e së cilëve është në Shqipëri. Në Vlorë ne jemi 200 shëngjergjas".

Pas tre muajsh qëndrimi në Shqipëri, më 1 korrik 1999, shëngjergjasit u kthyen në vendlindje. Por lanë mbrapa familje dhe vëllezër të një gjaku, të cilët e ndjenë largimin e tyre. I përcollëm me lot malli, por dhe gëzimi se po shkonin në vatrat e tyre ku s'kishte më ushtarë serbë. Qysh atëherë unë nuk jam ndarë kurrë prej tyre. Në shtëpinë e mësues Halitit kam marrë pjesë në tre gëzime familjare: në fejesën e një djali dhe në dasmat e dy të tjerëve. Kam shkuar katër herë në Zymë të Hasit, që është 19 km larg Prizrenit. Emrin e ka Has i Thatë, emër i cili ka një domethënie. Ky vend, i cili ndodhet 800 metra mbi nivelin e detit, ka disa basene pothuajse të thatë, që mendohet të kenë qenë liqene të vërtetë dikur, ndërsa më vonë u shndërruan në ara të bukura. Mirëpo, edhe këto ara të bukura, që dikur mbilleshin me kultura bujqësore, me emigrimin e hasjanëve dhe mospunimin e tyre janë shndërruar në livadhe. Mendoj, sa herë që shkoj atje dhe mrekullohem me këto bukuri, pse i ka mbetur ky emër. Shtëpitë dy a tre katshe të ndara në lagje, sipas fiseve krijojnë

një mozaik të mahnitshëm dhe gërshetohen bukur me natyrën përreth, por herën time të fundit në Has, më 13 tetor të këtij viti, unë përjetova një tjetër bukuri të tij: atë shpirtërore. Duke shkelur lagje më lagje, nëpër ato rrugica shtëpish të mbuluara me tjegulla të kuqe Marsejeze, mësoj dhe emrat e tyre sipas fiseve: Çollaku, Berisha, Kajtazi, Dodaj, Cakaj. Emra dhe mbiemra të një vendi tipik shqiptar. Para prishjes së Jugosllavisë, Zymi i Hasit kishte tre mijë banorë. Sot shumica ndodhet në kurbet dhe në fshat ka kryesisht të moshuar. Në zemër të Hasit, në Zym, pashë atë lum të madh hasjanësh, ardhur nga çdo vend i botës, aty, për të kremtuar në vendlindjen e të parëve të tyre tubimin "Takimet e Shtjefën Gjeçovit", një manifestim atdhetar - kulturor, i cili i ka fillimet e tij në vitet 1941-1943 nën emërtimin "Në kujtim të Gjeçovit". Pas vitit 1971 është kremtuar rregullisht çdo vit me emërtimin e sivjetshëm. Mësues Haliti më tregon për historinë e begatë kulturore të Hasit. Zymi është qendër famullitare që nga shekulli XIV. Priftërinjtë janë dhe njerëzit e mëdhenj të kulturës shqiptare, si: Andre, Pjetër, Lukë e Gjon Bogdani, Pjetër Zagonji, Mark Bardhi, Pjetër Karagiqi. Famullisë së Zymit i përkasin shtatëmbëdhjetë kishëza. Sot në qendër të Zymit ndodhet një kishë e bukur e Zojës së Madhe, e cila njihet me emrin "Zoja e Hasit". Në Shëngjergj ekziston kapela e Shën Prenës, ndërsa në lagjen Berishë të Zymit gjenden gërmadhat e kishës së Shën Gjergjit. Nga Zymi dhe i gjithë Hasi kanë dalë një numër i madh personalitetesh të shkencës, kulturës e artit, gjatë shek. XVI-XVIII, si: Pal Hasi Andre, Pjetër, Lukë e Gjon Bogdani, Pal Lumezi, Pjetër Nikë Dilë Kolëdoçi. Në Zym kanë shërbyer Gjon Nikollë Kazazi, Mëhill Suma, Shtjefën Gjeçovi. Nga Zymi kanë dalë Katarina Josipi e Anton Pashku, që të dy në amshim. Dikur në Zym ka qenë e atashuar konsullata austro-hungareze. Dhe po aty, në Zym, më 20 maj 1900, u kurorëzua botimi fillestar i "Abetares së Zymit". Ndaj po në Zym, më 13

tetor 2007, u promovua lapidari i "Abetares së Zymit 1900" nga përfaqësuesi i kulturës shqiptare në Prishtinë dhe burri i respektuar i Zymit, mësuesi i nderuar Nikollë Kërhanaj. Duhet thënë se shkolla këtu ka një histori më vete. Nga viti 1900 deri në 1918, mësimet jepeshin në gjuhën shqipe, më 1925 serbët e kthyen mësimin në gjuhën e tyre. Në këtë kohë, mësimet e gjuhës shqipe, nëpërmjet mësimëve fetare, i ka mbajtur At Shtjefën Gjeçovi, të cilin pushteti serb e vrau më 14 tetor 1929, në vendin e quajtur Rrëzina, afër Zymit. Sot, Zymi në qendër, ka shkollën 9-vjeçare dhe klubin letrar me të njëjtin emër "Shtjefën Gjeçovi", gjimnazin "Gjon Buzuku", shtëpinë e kulturës "Katarina Josipi". Shoqata kulturore-artistike "Katarina Josipi" është themeluar më 4 maj 1970, për nder të aktorese së madhe zymjane, e cila ndërroi jetë më 29 prill 1969 dhe prehet në varrezat e Shën Prenës, në Shëngjergj. Kjo shoqëri, që sivjet mbushi 37 vjetorin e themelimit të saj, ka në përbërje të vet bashkësinë rinore "At Shtjefën Gjeçovi", pastaj në Zym funksionon biblioteka "Pjetër Bogdani" dhe klubi i futbollit "Përpjekja". Ajo ka dhe kompleksin memorial të përruar në vitin 2006 nga kryeministri i Kosovës, Agim Çeku. Aktivitetet, kjo shoqëri i sinkronizon në mënyrë të vazhdueshme me çështjen kombëtare, duke çuar përpara e pasuruar më tej traditën zymjane, traditë kjo e përfshirë në tërësinë etniko-kulturore shqiptare. Hasi i njohur për veglat e thjeshta paramuzikore sezonale si pypi, bylbyli, fletëza e barit, parazani i punuar nga lëvozhga e frashrit apo e shelgut, është i dëgjuar për vallet e tij tipike hasjane, por edhe për çiftelinë, sharkinë, fyellin, kavallin, bishtnicën, të cilat i përdor në gëzime familjare e kolektive. Miku im, mësues Haliti, që unë shpesh i thërras vëllai im i vogël, mi tregoi këto gjëra konkretisht më 13 tetor 2007, në ditën e shenjtë të At Shtjefën Gjeçovit, ndërsa më prezantonte me bashkëfshatarët e tij hasjanë, por edhe me shumë intelektualë të ardhur nga Prishtina, Prizreni, Gjakova, etj. Në këtë ditë, ku takoheshin

bashkëfshatarë e bashkëmoshatarë, të rinj e të reja që vinin nga kurbeti, punëtorë, profesorë, doktorë, akademikë, bashkohej dhe shpirti At Shtjefën Gjeçovit dhe i atyre figurave të shquara që preheshin në varrezat e Shën Prenës, e që vargu i njerëzve u çonte kurora e tufa me lule të freskëta. Atmosfera u bë më mbresëlënëse kur në kompleksin përkujtimor të amfiteatrit të hapur pritet të vendosën shtatoret e Pjetër Bogdanit, At Shtjefën Gjeçovit, Anton Pashkut e Katarina Josipit. Në këtë manifestim përshëndetën akademik Mark Krasniqi dhe publicisti e politikani Veton Surroi. Ndërsa ndiqja me interes çdo fjalë të tyre, shtanga kur dëgjova emrin tim. Përshëndeta të pranishmit në emër të shoqatës kulturore atdhetare "Cakrani", ku unë jam kryetar i saj dhe në emër të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Vlorës, ku unë jam anëtar. Por unë përshëndeta në radhë të parë si qytetar i Vlorës, vendit të Flamurit dhe të Pavarësisë, duke u uruar pavarësinë atij populli që është pjesë e kombit tim.

Tashmë që ka kaluar pothuajse një muaj nga takimi im në Has, ndjej një mall të papërshtatshëm. Më vijnë në vesh fjalët e ky kolosëve të mendimit hasjan Frrok Marjan Kristaj dhe Nikollë Mark Kërhanaj, se një ditë do të vejë në vend padrejtësia historike. Ndjej mikpritjen e mësues Halit. Është një mall shqiptarie... Është një mall pavarësie prej afro një shekulli, është një mall bashkimi që unë pres ta shuaj më 28 Nëntor!

**Dr. Asqeri LLANAJ**

**Të nderuar zotërinjë Frrok Kristaj e Nikollë Kërhanaj!**

*Vlorë, 20 mars 2008* - Në arsenalin e festave tuaja hyri edhe 17 shkurti 2008, që është kurorëzimi i përpjekjeve të At Shtjefën Gjeçovit, Katerina Josipit e të gjithë patriotëve hasjanë e mbarë kosovarë. Ishte dita më e veçantë për të gjithë shqiptarët, kudo që ndodhen. Më në fund, të gjithë ne ndjemë të realizohej

ëndrra shekullore për ta parë Kosovën të lirë, të shkëputur përfundimisht nga Serbia; u realizua dëshira e popullit kosovar të martirizuar në shekuj, që arriti t'i mbijetonte represionit serb, të fitojë pavarësinë e të shënojë në faqet e historisë Kosovën shtet i pavarur.

Më 17 shkurt festa e gëzimi mbarëpopullor kishte pushtuar mendjen dhe zemrën e çdo shqiptari, kudo ku ndodhej. Kudo, në çdo shesh e rrugë, dëgjohej muzikë për triumfin e pavarësisë së Kosovës, që diti t'i respektojë procedurat ligjore dhe të bëjë aktin e pavarësisë, një dokument legjitim për njohjen e shtetit më të ri në botë.

Fitorja e pavarësisë së Kosovës është një nga aktet më madhore që shqiptarët përjetuan të dielën në Sheshin e Prishtinës dhe në sheshet e gjithë botës ku punojnë e jetojnë shqiptarët. Kosova manifestoi madhërishtë, duke i treguar botës se sa e rendësishme është pavarësia dhe liria për popujt paqedashës e liridashës, që u dhunohet e u cunohet e drejta e trojeve të tyre. Tashmë për Kosovën e shqiptarët ka filluar epoka e realizimit të të drejtave dhe lirive njerëzore individuale e të bashkësisë. Do të festojmë në Vlorë 28 Nëntorin e në Prishtinë 17 Shkurtin.

E ajo ditë do të vijë, i gjithë kombi shqiptar të ketë një Ditë Pavarësie.

Na ka lënë mbresa dita e shenjtë e komunitetit zymjan e atij mbarëkosovar, më 13 tetor 2007, manifestimi tradicional letrar, kulturor e shkencor "Takimet e Gjeçovit".

Të nderuar zotërinj Frrok e Nikollë! Ju kam zili ju, si vazhdues të at Shtjefën Gjeçovit, Katerina Josipit, Anton Pashkut e shumë e shumë të tjerëve, që kanë bërë histori, të Zymit e të mbarë kombit shqiptar. Këta atdhetarë, me veprat e tyre, qëndrojnë në piedestalin e Hasit të Thatë, të Zymit dhe të Kosovës, dhe ju, si përcjellës të traditave hasjane, atje e keni vendin.

Të nderuar Frrok e Nikollë!

Klubi letrar “Shtjefën Gjeçovi”, SHKA “Katarina Josipi”, revista “Zëri i Hasit” kanë vulën tuaj, vulën e patriotizmit e të atdhedashurisë, të lidërshiptit popullor. Ju jeni njerëz që bëni historinë, njerëz të letrave shqipe, njerëz që vlerat kombëtare, shpirtërore e atdhëtare i keni trashëguar e transmetuar për dyzet vjet ndër breza dhe vetë jeni shndërruar në vlera qytetare, në më shumë se një figure popullore. Ju meritoni një nderim, një kujtim e një obligim shpirtëror e moral për të sjellë në ditët e sotme çdo gjë të “gjallë” si dikur.

Ju, të nderuar bijë të Zymit, meritoni falenderime të përzemërta e mirënjohje të çiltër e të dliirë.

Një obligim, sa shpirtëror e qytetar, sa intelektual e atdhëtar, u detyroheni ju figurave zymjane, At Shtjefën Gjeçovit, priftit françeskan, i cili u lind në fshatin Janjevë dhe aktivitetin, veprimtarinë e ka ushtyruar në zonën e Hasit të Thatë. Ndaj njihet i biri i tyre dhe eshtrat e tij prehen në varrezat Kapela e Shën Prenës në Shëngjergj. Kontributi i tij është shumë i madh në lëmin e letërsisë gojore, në lëmin e folklorit. Ai mbledhi materiale folklorike me vlerë të madhe, si: këngë popullore, gojëdhëna, mitologji, thënie e fjalë të urta, fjalë të rralla, kashelashe e lojëra fëmijësh, gojëdhëna për Skënderbeun, por ishte edhe dramaturg i madh e atdhëtar. Më 1920 ai ka ngritur Flamurin Kombëtar në kalanë e Kaninës në Vlorë.

Katarina Josipi, bijë e Zymit, eshtrat e të cilës prehen në varrezat e kishës së Shën Prenës, në fshatin Shëngjegj, është një nga aktoret e para kosovare. Për 21 vjet me radhë, ajo interpretoi në skenën e Teatrit Profesional të Prishtinës mbi shtatëdhjetë e tri role. Interpretimet e saj ishin të gjalla, origjinale dhe ngjallnin emocione tek shikuesit. Ato janë të arkivuara në memorien e publikut. Katarina ka rrezatuar gjithmonë vlera kombëtare. Ndërroi jetë më 29 prill 1969. Në nderim të saj, më 4 maj 1970, ju, të nderuar zoti Frrok e Nikollë e shumë dijetarë e intelektualë të tjerë hasjanë

themeluar në Zym të Hasit Shoqërinë kulturore artistike “Katarina Josipi”.

Me punën tuaj studimore e publicistike, ju keni dhënë një kontribut të çmuar ndaj këtyre gjenialëve hasjanë. Me aftësitë depërtuese, sinqeritetin, entuziazmin, humorin e shpirtin tuaj të mirë, na keni folur, kohë pas kohe, në tridhjetë e shtatë manifestime “Takimet e Gjeçovit”, festave letrare, artistike e shkencore, SHKA “Katarina Josipi”. Në zemër të Hasit, në mënyrë madhështore, është ngritur Kisha e Zojës së Madhe, që njihet si Zoja e Hasit, e cila rrezaton vlerat shpirtërore të Jezu Krishtit, që përkujtohet e festohet për çdo 15 gusht dhe ajo e Shën Prenës, që festohet më 26 korrik, dita e kurbetçinjve dhe “Bashkësia Rinore” e shumë festa të tjera.

Olimpi, mal në veri të Greqisë, me 2918 metra lartësi, sipas mitologjisë greke, ishte rezidenca e perëndive. Zymi është 800 metra mbi nivelin e detit. Aty nuk ka mitologji, por ekziston një realitet abjektiv. Aty prehen eshtrat e shumë dijetarëve dhe shenjtorëve. Një nga ato që ju përgjithësoni me shtatore është Nënë Tereza. Ju, në ditët e shenjta, e zbuloni shtatoren me kurora e tufa me lule. Nga duart e saj janë perkëdhelur me mijëra njerëz, burra, gra e sidomos fëmijë, pa dallim race, ngjyre, moshe, gjinie, feje, shtrese apo ideologjie, por si bija e bijë të Zotit.

Nënë Tereza, për të zhdukur fanatizmin fetar si sëmundje shekullore, thoshte: “I krishteri le të bëhet i krishterë edhe më i mirë, hindusi le të bëhet hindus edhe më i mirë, budisti le të bëhet budist edhe më i mirë, muhamedani le të bëhet muhamedan edhe më i mirë”.

Ajo, me këtë bindje të thellë që kishte, vepronte në mbarë botën me një botëkuptim të ri mbi njeriun. Raca, feja e kombi nuk mund të na ndajnë dot, sepse të gjithë jemi bijat e bijtë e Hyjit. Ajo i dashuronte të gjithë me dashurinë e pastër të Hyjit, në veçanti të braktisurit e botës.

Nënë Tereza është gen i kombit tonë, bijë e lindur në truallin tonë. Tani kleri ortodoks maqedonas në shtëpinë e saj do të ndërtojë një kishë ortodokse maqedonase. Me këtë veprim ai kërkon me çdo kusht ta përvetësojë figureën e saj dhe t'i humbas identiteti shqiptar. Po bota e nderon Nënë Terezën si Nënë e Madhe.

Nënë Tereza, duke e përhapur dashurinë dhe lavdinë lumturore të Hyjit nëpër mbarë botën, si realizim dhe përmbushje të jetës së vet, përhap “Misionaret e dashurisë” dhe ndërtoi në vende të ndryshme me qindra tenda dashurie, kuvende, shkolla, spitale, strehimore, kuzhina, qendra asistence etj. Bota e qytetëruar e vetëdijësuar për veprën e madhe njerëzore që bënte Nënë Tereza, apostulli bashkohor i dashurisë ungjillëzuese, i dhuroi kësaj gruaje fisnike e bujare dhurata të shumta e shpërblime kombëtare e ndërkombëtare, që nga viiti 1963 e deri tek mirënjohja e muajit gusht të vitit 1997, kur Nënë Terezën bota e shpalli personalitet të shekullit XX, duke e lartësuar në Lavdi.

Nënë e Krishtit, Zoja e Bekuar, vetëm të krishterët e quajnë “Nënë hirëplote”, ndërsa Nënë Terezën, e cila aq shumë i është lutur kësaj Nënë Hyjnore, të gjithë kombet e nderojnë për nënë të botës, duke u gjuhëzuar me nderim para veprës së saj të pavdekshme. “Po jua prezantoj gruan më të fuqishme të botës”, deklaroi në vitin 1985, pas Asamblesë së përgjithëshme të OKB, sekretari Xavier Peres de Cuellar.

Ju bashkërendoni ngjarje në kohë, që, dhe kur i rilexoni sot, të befasojnë për aktualitetin që kanë, me ato programe dhe organizime impresionuese, të cilat rrisin vlerat letrare, kulturore e shkencore, si akumulim historik i Hasit të Thatë.

Mosha juaj kalon, zotërinj Frrok e Nikollë, por kredibiliteti juaj rritet. Është e natyrshme që, kur ju keni themeluar këto aktivitete, keni marrë vlerësime, buzëqeshje e ndjenja shpirtërore. Tani ato patjetër janë shumëfishuar.

Kur u ndava me zotin Nikollë, e falenderova. Përgjigjia e tij ishte me rënie lotësh. Çfarë gëzimi për të e për mua nga Vlora. Si miq të vërtetë u ndamë me gëzim, me sinqeritet, me dashuri e respekt. Ata janë lotët e shpirtit të pastër të Nikollës, kurse unë lexoja vlora, shembuj krijimtarie, të cilët na shërbejnë ne për të marrë shembuj nga këto vlora mbarëkombëtare. Këto të shkëpusin nga hijet, të rrisin dashurinë për njerëzit, sinqeritetin në punë, në mjedisin social e familjar.

Aktivitetet kulturore, letrare e shkencore këto dyzet vjetët e fundit në Zym të Hasit e kanë emrin e Frrok Kristajt e të Nikollë Kërhanajt, shkrimtarë, gazetarë, arsimtarë dhe veprimtarë të mirënjohur e të rrespektuar. Këta pasqyrojnë figura popullore, modeste e të shquara. Me bujarinë e përkushtimin intelektual, së bashku me intelektualë të tjerë të letrave, sjellin projekte të tjera, jo vetëm për Hasin e Thatë, historikun e tij. Ky kontribut që jepni ju dhe inteligjenca e i gjithë ai komunitet, pasurojnë arsenalin letrar e folklorik të Hasit të Thatë, si dhe shpirtin e madh kombëtar.

Ju lumtë bijve e bijave hasjanë për kontributin mbarëkombëtar!

*(Marrë nga libri i Asqeri Llanajt “Dialog me tokën”)*

## **Në përkujtim**

### **Hermína (Delhysa) Lekaj**

Në nëntor të vitit 2007 pas një sëmundje të rëndë, kaloi në amshim (në Lubjanë të Sllovenisë) mexosopranja Hermine Delhysa - Lekaj. Tashmë e ndjera ishte e lindur në Prizren, ku edhe e kishte kryer shkollën fillore dhe shkollën e mesme të muzikës, kurse studimet i kishte përfunduar në Beograd.

Profesoresha Hermína Lekaj padyshim se ishte ndër mexopronet më të njohura, por njëherësh ishte edhe profesoreshë në Degën e muzikës të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës. Atë edhe sot e përkujtojnë

artdashësit e muzikës. Përkujtohet vepra dhe krijimtaria e saj shumë e bujshme.

“Janë gjithmonë të zymta dhe pikëlluese, ndarjet e përmortshme nga kolegët, miqtë dhe artistët tanë, të cilët tërë jetën e tyre e shndërruan në një mision të vetëm: ecje në drejtim të dritës dhe të bardhës”- pat thënë prorektori i Universitetit të Prishtinës, Marjan Demaj. Me një zë të bukur dhe të ëmbël, Hermina u dallua edhe gjatë studimeve me angazhimet e saja, pasi që ishte studentja e vetme e brezit të saj që u inkuadrua në korin e njohur të Akademisë së Arteve të Beogradit, për të pasur, madje edhe disa paraqitje solistike, siç ishte sidomos roli në veprën e Mocarit. Mexosopranoja Hermina Lekaj, ishte një prijatë e zhvillimeve kulturore të ne, qoftë edhe me faktin, ku aq pak të ne, flitej për muzikën operistike. Shtëpia dhe familja e saj ishin edhe skena, fakulteti, edhe studentët të cilët e deshën dhe e respektuan aq shumë pedagogen e tyre që iku heshtur dhe shumë e re. Por hapërimi i saj i qetë, i sigurt, janë ende ndër ne. Mexosopranoja Hermina Delhysa - Lekaj gjatë punës së saj ka marrë pjesë në shumë koncerte operistike në vend dhe jashtë.

Hermina Lekaj u varros me nderime të larta në varrezat e Kapelës së Shën Prenës në Shëngjergj, afër Zymit të Hasit.

### **Gjin (Lazër) Kërhanaj**

Në krahasim me shoqatat tjera kulturore, Klubi Futbollistik i Zymit ka një histori më të largët. Më 14 gusht 1958, ishte mbajtur Kuvendi Themelues i klubit të përbashkët futbollistik në Rogovë të Hasit, sepse aty ishte fusha sportive. Në Zym nuk kishte terren adekuat për futboll. Me atë rast anëtar i Kuvendit Themelues ishte edhe Gjin Kërhanaj, ku u vendos që klubi futbollistik të pagëzohet me emrin “Pashtriku”. Lojërat zhvilloheshin kryesisht në Rogovë, kurse ato miqësore në Zym.

Me suprimimin e disa komunave në vitin 1965 ishte përfshirë edhe komuna e Zymit, që kishte vështirësuar veprimtarinë e sportistëve, sidomos bashkëpunimim me sportdashësit e Rogovës së Hasit.

Megjithatë, dashamirët e sportit u tubuan në Kuvendin themelues, më 19 maj 1974, në Zym, ku klubi u ripagëzua me emrin “Përpjekja”, ku po ashtu Gjin Kërhanaj prapë ishte zgjedhur kryetar. Skuadra përbëhej prej 30 lojtarësh dhe 240 anëtarë e simpatizantë që dhanë ndihma materiale për regjistrim në Lidhjen e Qarkut të Prizrenit.

Me gjithë vështirësitë, klubi futbollistik “Përpjekja” vazhdoi veprimtarinë deri në stinorin 1988/89 kur u pezullan të gjitha shoqëritë qytetare e sportive. Mirëpo, në shtatorin e vitit 1999, zymjanët klubin futbollistik e pagëzuan me emrin e ri “Zymi”. Do përmendur se edhe me atë rast Gjin Kërhanaj ishte zgjedhur kryetar.

Me nisëativën e Gjin Kërhanajt, u ndërta edhe fusha sportive në fshatin Shëngjergj (te Fusha e Kronit), e cila u përrua më 23 tetor 1988.

Për këtë veprimtari rreth 50-vjeçare, të rinjtë e Zymit, me rastin e organizimit të një gare dyditësh në ditën e kurbetçarëve, më 17 prill 2006 (të hënën e Pashkëve), veteranit të sportit, njëherit edhe kryetarit shumëvjeçar të klubit futbollistik, Gjin Kërhanajt, në shenj mirënjohje ia dhanë një shpërbllim prej 500 Eurosh.

Me rastin e kalimit në amshim të Gjin Kërhanajt, fjalën e përmortshme e mbajti aktivisti i dëshmuar Gjokë Kolëndrekaj.

## **Zef (Marjan) Kristaj**

*(29 gusht 1935 – 26 gusht 2008)*

Zef Marjan Kristaj u lind në Zym të Hasit, më 29 gusht 1935. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, gjimnazin real e filloi në Prizren dhe e vazhdoi në Krushe të Madhe (komuna e

Rahavecit) dhe e kreu në fshatin Runik të komunës së Skenderajt, shkollën e mesme e filloi në Pejë e vazhdoi në Prizren dhe e kreu në Mitrovicë, kurse shkollimin e lartë e filloi në Prizren dhe e kreu në Gjilan.

Detyrën e shenjtë të mësuesit e filloi në fshatin Uçë të komunës së Istogut dhe e vazhdoi në fshatrat e Hasit - në Planejë, Luginë, Krajk, Mazrrek, Gjonaj e në Zym, ku përveç që punoi me nxënës të rregullt, u angazhua edhe me kurset analfabetike dhe ato të amvisnisë.

Gjatë shkollimit fillor u angazhua në grupin dramatik të Shkollës së Zymit, ku interpretoi në disa pjesë teatrale, që u shfaqen në Zym dhe në Rogovë të Hasit.

Po ashtu, gjatë viteve 1959 e 1960, derisa e kryente detyrën e mësuesit në fshatrat e Hasit, bashkëpunoi me gazetën “Rilindja”, ku botoi artikuj për jetën dhe ngjarjet më aktuale në fshatrat e Hasit.

Më vonë kaloi në administratë, ku në Zyrën e Vendit në Zym e kreu detyrën e ofiçarit dhe të udhëheqësit të Zyrës së Vendit. Më vonë ishte udhëheqës i Postës në Zym nga edhe u pensionua.

Zef Kristaj gjatë shërbimit në Zyrën e Vendit dhe në Postë, ishte edhe kryetar i Bashkësisë Lokale të Zymit. Atëbotë edhe kontribuoi në organizimin e aksioneve për ngritjen e infrastrukturës së fshatit. Me angazhimin e tij u bë renovimi i objektit dhe i oborrit të Zyrës së Vendit, si dhe objektit të Postës në Zym.

Zef Kristaj kaloi në amshim, më 26 gusht 2008, dhe u varros në varrezat e Kapelës së Shën Prenës në Shëngjergj.

## **Përmbajtja**

Parathënia

Takimet e Gjeçovit 2007,

Frrok KRISTAJ: Manifestim i denjë me traditë kombëtare e shpirtërore,

Albert MARJAKAJ: U zbulua shtatorja e Atë Shtjefën Gjeçovit,

Nikollë KËRHANAJ: Tradita kulturore e zymjanëve,

Babadimri për Vitin e Ri,

Trinia e Shenjtë,

Dita e Mësuesit dhe 10-vjetori i epopesë së UÇK-së,

Dita e kurbetçarëve,

Në “Hasi jehon” - “Katarina Josipit” vendi i parë,

“Katarina Josipit” – vendi i dytë,

Në Zym - komandanti i KFOR-it,

Binjakëzimi i Zymit me Emdenin e Gjermanisë,

“Katarina Josipi” në “Gjurmë të Perandorit Justinian”,

KFOR-i italian pajisë me inventar Shkollën e Zymit,

Frrok Kristajt – çmimi “Akil Koci”,

Fondi për studentë të dalluar,

Prezantime

Frrok KRISTAJ: Abetarja e Zymit dhe Kongresi i Manastirit,

Frrok KRISTAJ: Kati - atdhetare dhe primadonë e teatrit,

Mr. Besim MUHADRI: Tradita hasjane e shkrimit të shqipes,

Të tjerët për zymjanët

Dr. Asqeri LLANAJ (Vlorë): Në Has të Thatë, me vëllezërit e një gjaku,

Dr. Asqeri LLANAJ: Të nderuar zotërinjë Frrok Kristaj e Nikollë Kërhanaj,

Në përkujim

Hermina (Delhysa) Lekaj,  
Gjin (Lazër) Kërhanaj,  
Zef (Marjan) Kristaj,

## **Takimet e Gjeçovit 2007**

E përgatitën:  
Frrok KRISTAJ e Nikollë KËRHANAJ

Klubi letrar “SHTJEFËN GJEÇOVI” në Zym  
Për botuesin:  
Nikollë KËRHANAJ

Dizajni: Kreshnik Smajlaj

Tirazhi:  
300 copë

U shtyp në shtypshkronjën  
extreme  
Prishtinë  
2008